



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Marketing
Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universitet "EPOKA"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Arlinda Ymeraj


2. Dr. Ana Buhajjoti

Qershor/2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”, ofruar nga Universiteti Epoka

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Epoka
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Biznesi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 222, datë 31.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 14, datë 19.01.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 288, datë 30.05.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli 1
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2016-2017, 29 Studentë V.A 2017-2018, 25 Studentë V.A 2018-2019, 36 Studentë V.A 2019-2020, 43 Studentë V.A 2020-2021, 33 Studentë V.A 2021-2022, 34 Studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Epoka", është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 281, datë 12.03.2008. Universiteti "Epoka", që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Universiteti "EPOKA" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.92, datë 20.10.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2021. Aktet rregullatore të IAL-së, Statuti e Rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e Lartë dhe aktet normative në fuqi, siç janë konstatuar dhe nga GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në IAL.

Universiteti "Epoka", është i organizuar në 3 fakultete, 2 Qendra kërkimore dhe 8 departamente. Fakultetet në përbërje të Universiteti "Epoka", janë:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;
2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Programi i studimit Bachelor në "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Ky fakultet përbëhet nga:

- Departamenti i Ekonomiks;
- Departamenti i Financë-Bankë;
- Departamenti i Administrim Biznesit.

Programi i studimit Bachelor në "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik" është pjesë e Departamentit të Administrim Biznesi, dhe është licencuar me Urdhër Nr. 222, datë 31.05.2013, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 155 datë 16.05.2016 te Ministrit të Arsimit dhe Sportit për 6 (gjashtë) vite akademike.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik" ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze është i organizuar me kohëzgjatje normale studimesh prej tre (3) vitesh akademike, me 180 ECTS.

Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik" e regjistruar me Vendim Nr. 427, datë 20.03.2017 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Programi i studimit është ndërtuar mbi një përvojë të mirë institucionale dhe reflekton vlerat akademike dhe shkencore të saj. GVJ vlerëson programin si risi në edukimin marketing në Shqipëri duke orientuar marketingun drejt prirjeve ndërkombëtare në përputhje me prirjet e tregut të punës drejt integritit në BE dhe globalizimit. Programi konsiderohet pioner në


thelimin e njohurive dhe aftësive të studentëve në funksionin e logjistikës ndërkombëtare, si kontribut në zhvillimin e aftësive menaxheriale të bizneseve eksportuese shqiptare. Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” është në përputhje me kërkesat dinamike të tregut të punës kombëtar e ndërkombëtar. Ai mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve në Marketing si një mundësi për lidhjen e studentëve me një funksion menaxherial marketing ose logjistikë që në ciklin e parë të studimit. Por nga ana tjetër paraqet një sfidë për zhvillimin e njohurive të përshkallëzuara nga nevojat lokale dhe rajonale, deri tek njohuritë mbi ekonominë globale, esenciale për formimin profesional të studentëve.

GVJ gjykon që programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” është program bashkëkohor, i hartuar me një mentalitet të orientuar drejt tregut, në mënyrë që t’i shërbejë bizneseve dhe shoqërisë duke përballuar kërkesat në rritje dhe dinamizmin e tregut, si edhe integritet të vendit në ekonominë rajonale, europiane dhe globale. Sidoqoftë, argumentimi nga drejtuesit e njësisë, mbi përparësitë e këtij program, mbase i vetmi i këtij lloji në vendin tonë, nuk mbështetet në evidenca dhe të dhëna, që dëshmojnë për nevojën e tregut shqiptar për specialistë të fushës së mësipërme.

GVJ rekomandon që njësia përgjegjëse e programit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” të ndërmarrë një studim të argumentuar dhe shkencor tregu në funksion të indentifikimit të nevojave të tregut të punës dhe aftësinë e programit për të përcjellë kompetencat e duhura tek studentët. Njësia përgjegjëse duhet të rishikojë prirjet dhe ndryshimet e shpejta në fushën e Marketingut me orientim në logjistikën ndërkombëtare në mënyrë që të diversifikojë njohuritë e programit dhe përforcojë avantazhet e tij në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit. Kjo kërkon gjithashtu të rishikohet kurrikula në harmoni me kërkesat e punëdhënësve për sektorin e marketingut dhe aplikimin e parimeve të manaxhimit logjistik ndërkombëtar në sektorin logjistik vendas në përafrim të praktikave rajonale.

Konsideruar të dhënat sipas kualifikimit të stafit akademik dhe raportet midis tyre, GVJ rekomandon rritjen e mësimdhënësve më gradën shkencore profesor për PAE. Stafi mësimdhënës i programit të studimit i takon masivisht kategorisë së moshës 25-35 vjeç dhe mban statusin e pedagogë pa tituj akademikë. Njësia bazë ka mungesë të burimeve njerëzore të kualifikuara për këtë program studimi. *GVJ rekomandon të rritet numri i PAE me grada dhe tituj si kusht për mësimdhënie në programin e studimit dhe zhvillimin e kopentencave kërkimore-shkencore të tij.*

GVJ rekomandon që IAL të përmirësojë procesin e rekrutimit të personelit akademik me grada dhe tituj konsideruar objektivat kërkimore-shkencore të programit por edhe të IAL-së në tërësi.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Këshilli i Akreditimit, bazuar në Vendimin Nr. 155 datë 16.05.2016 për akreditimin e Programit të ciklit të parë Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” nuk ka pasur asnjë rekomandim për këtë program studimi, duke dhënë vlerësim pozitiv në përmbushje të “Standarteve Shtetërore të Cilësisë”.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”, ka ndjekur hapat rigorozë të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Procesi nisi me kontaktin e ekspertëve, të cilët u trainuan për standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të brendshëm dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion.

Në fazën e dytë u zbatua me rigorozitet axhenda 2 ditore e vizitës në institucion datat 9 dhe 10 Shkurt 2022. GVJ mblodhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Drejtuesin e Departamentit të Administrim Biznesi , grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sekretarinë mësimore, Drejtorinë Burimeve Njerëzore, Zyrën Alumni dhe të Projekteve, dhe Studentët e të tre viteteve të programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof As. Arlinda Ymeraj dhe Dr. Ana Buhaljoti për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë të gjithë procesit ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentave të vëna në dispozicion në sistemin e ASCAL, të GVB, si edhe vizitës dy ditore pranë Departamentit të Administrim Biznesit, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Universiteti Epoka.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm. Në hartimin e raportit, grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të qarta duke vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, nivelin dhe performancës së personelit akademik, vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion. Raporti i vlerësimit të jashtëm ju dorëzua koordinatorit teknik të ASCAL.


Më datë 16.05.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 29/24 Prot., datë 16.05.2022, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS,

më datë 23.05.2022, dhe me shkresë zyrtare Nr. 95/5 Prot., datë 23.05.2022, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.3, Kriteri 1 dhe 2, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm pranon në përputhje me sugjerimin e GVJ se Zyra e Karrierës do të angazhohet për të bërë studimin e tregut.
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.3, Kriteri 3 GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep evidenca konkrete që kundërshtojnë orët mësimore të studentit. Sa i takon lëndëve të formimit karakterizues ato janë me zgjedhje dhe GVJ sugjeron të përfshihen në lëndët e detyrueshme, koment i cili **ka ndryshim në raport** dhe saktësohet sa vijon *“Për këtë nevojitet të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së lëndëve Marketing Dixhital, Menaxhim i forcës së shitjes, Menaxhim i kanaleve të shpërndarjes, Menaxhim global i logjistikës, Prokurimi Ndërkombëtar, Inovacioni etj të detyrueshme në program.”*
3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.4, Kriteri 1, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep evidenca që kundërshtojnë vlerësimin.
4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.5, Kriteri 3, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin.
5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1, Kriteri 2, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi GVB nuk jep më shumë informacion dhe evidenca mbi zgjedhjen e këtij programi si edhe përpunueshmërisë së tij me kërkesat e tregut shqiptar.
6. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.4, Kriteri 1, GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** pasi ka mospërputhje mes tabelave 10.5 dhe tabela 13. Ndësa nuk ekziston tabelë 10.6 që kundërshton vlerësimin në raport. Vlerësimi ndryshon si vijon *“GVJ konstatoi se të dhënat e tabelës 10.5 nuk përputhen me të dhënat e tabelës 13, tek e cila rezultojnë 1.808 orë gjithsej në auditor. Njësia duhet të saktësojë të dhënat”*
7. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.4, Kriteri 6, GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** pasi GVB jep evidenca shtesë (Shtojca 20) për argumentimin e përputhshmërisë së programit me kërkesat e tregut.
8. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.2, Kriteri 4, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep evidenca që kundërshtojnë vlerësimin. GVJ i qëndron rekomandimit, të rritet numri i PAE me grada dhe tituj si kusht për mësimdhënie në programin e studimit dhe zhvillimin e kopentencave kërkimore-shkencore të tij.
9. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.2, Kriteri 4, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVJ në këtë standard është sugjerim në të mirë të procesit dhe përforcon argumentin e GVB.


10. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.3, Kriteri 4, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk kundërshton konstatimin e GVJ i cili bazohen në inspektimin nga afër dhe njohjen me infrastrukturën e mësimdhënies.
11. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.7, Kriteri 2, GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** në përputhje me Standardin I.3 dhe saktësohet sa vijon *“Për këtë nevojitet të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së lëndëve Marketing Dixhital, Menaxhim i forcës së shitjes, Menaxhim i kanaleve të shpërndarjes, Menaxhim global i logjistikës, Prokurimi Ndërkombëtar, Inovacioni etj të detyrueshme në program.”*
12. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.7, Kriteri 6 dhe 9, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVJ në këtë standard është sugjerim në të mirë të procesit dhe përforcon argumentin e GVB.
13. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.2, Kriteri 4 GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVJ vetëm evidenton që 8 anëtarë të stafit realizojnë normë ngarkese mbi 250 orë në auditor, por nuk cënon vlerësimin maksimal të standardit.
14. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.6, Kriteri 1-5 GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi dokumentat shtesë të dërguara nga institucioni Shtojca nr 11, 12,13 janë të njëjta me ato të konsultuara më parë.
15. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.1, Kriteri 2 GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** pasi GVB ka paraqitur dokumenta shtesë (Shtojca 20) mbi rezultatet e pyetësorit. Komenti ndryshon në *“GVB paraqiti evidenca shtesë Shtojcë 20 që dëshmon mbi opinionet e studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në institucion”*
16. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.1, Kriteri 3 GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** pasi GVB ka paraqitur dokumenta shtesë (Shtojca 6) mbi vlerësimin e studentëve për programin e studimit. Komenti ndryshon në *“GVB paraqiti Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS si instrument për vlerësimin e cilësisë së procesit akademik.”*
17. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.1, Kriteri 4 GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** bazuar në dokumentacionin e dërguar nga GVB përkatësisht *Shtojcat Nr 1,2,3,4,5,6.*
18. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi VI.2 Kriteri 1 dhe 2, GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** bazuar në dokumentat shtesë. Përkatësisht *“GVB ka paraqitur dokumentacion plotësuese, përkatësisht Shtojcat Nr 1,2,3,4,5,6 mbi shkallën e përdorimit të mekanizmave dhe efektivitetin e proceseve formale. GVJ inkurajon njësinë përgjegjëse për vlerësim dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të programit të studimit”*
19. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.2 Kriteri 3 GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport**, pasi dokumentat shtesë të dërguara nga institucioni nuk evidentojnë shkallën e zbatimit të këtyre politikave .
20. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.2 Kriteri 4 dhe 5, GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** bazuar në dokumentat shtesë, *Shtojca plotësuese Nr. 1,2,3,4,5,6* mbi dokumentimin e rezultateve për vlerësimin e cilësisë.



21. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.3 Kriteri 1 GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi GVB nuk jep argumenta dhe evidenca shtesë lidhur me këtë kriter.
22. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.3 Kriteri 4 **ka ndryshim në raport** bazuar në dokumentat shtesë, *Shtojca plotësuese Nr. 1-6*.
23. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.5 Kriteri 3 **ka ndryshim në raport** bazuar në dokumentat shtesë, *Shtojca plotësuese Nr. 1*

Bazuar në sa më sipër, GVJ gjykon se vlerësimi i Standardit IV **ndyshon nga Përmbushet pjesërisht** në **Përmbushet kryesisht**.

Së fundi vlen të theksojmë se bazuar në dokumentacion dhe vizita në institucion, GVJ ka bashkëvepruar për të ndërtuar një raport sa më realist dhe ndihmues për institucionin.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” është pjesë e Departamentit të Administrim Biznesi, dhe është licencuar me Urdhër Nr. 222, datë 31.05.2013, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 155 datë 16.05.2016 te Ministrit të Arsimit dhe Sportit për 6 (gjashtë) vite akademike.</p> <p>Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze është i organizuar me kohëzgjatje normale studimesh prej tre (3) vitesh akademike, me 180 ECTS.</p> <p>Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” e regjistruar me Vendim Nr. 427, datë 20.03.2017 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar mbi një përvojë të mirë institucionale dhe reflekton vlerat akademike dhe shkencore të saj.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të universitetit, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” përbën risi në ofertën akademike dhe është në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar të punës. Programi është i orientuar në lidhjen e praktikave mësimore me politikat kombëtare të zhvillimit dhe ka kontribut direkt në zhvillimin e tregut të punës drejt integritimit në BE dhe globalizimit.</p> <p>Formimi i studentëve në marketing dhe logjistikë, i përshkallëzuara nga nevojat lokale dhe rajonale deri tek ato mbi ekonominë globale, është domosdoshmëri për zhvillimin e ekonomisë së hapur, dhe gjithashtu i paraprin vizionit të zhvillimeve të tregut të punës në Shqipëri e më gjerë dhe në fushën përkatëse.</p>

	<p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit. Në statutin dhe rregulloren e brendshme të Universitetit EPOKA gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegjinale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Synimi i Universitetit EPOKA ka qenë hartimi i programit të studimit në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur eficientë institucionale.</p> <p>Statuti dhe rregullorja janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërvarura me njëra – tjetrën në kërkim të standarteve akademike e kërkimore, mësimdhënies, vëmendjes ndaj studentëve, dhe mbështetjen për biznesin e nevojat e zhvillimit perspektiv të shoqërisë.</p> <p>Veprimtaria kërkimore-shkencore e Universitetit EPOKA zhvillohet në përputhje me nevojat ekonomike e sociale të vendit dhe synon tu paraprijë sfidave të zhvillimit dhe integritit të vendit në strukturat europiane, si zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të ofertës dhe prodhimit vendas dhe rritjes së konkurrencës.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit “Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik” është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë në Shqipëri dhe vlerave kombëtare të edukimit si dhe me vlerat kulturore kombëtare, tashmë të ekspozuara dhe në funksion të integritit ekonomik.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i> <i>Aneksi 5. Rregullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik” është në përputhje me misionin e Universitetit EPOKA për tu transmetuar studentëve një edukim cilësor dhe dije të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë, bazuar në nevojat globale dhe rajonale.</p>

	<p>Programi i studimit reflekton dijet, aftësitë dhe kopetencat e kërkuara nga tregu i punës dhe është në përputhje me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të universitetit EPOKA. Tek misioni i IAL-së vihet theksi tek orientimi nga kërkimi shkencor duke siguruar një arsimim të nivelit të lartë, me dije bashkëkohore në zhvillimin e kapaciteteve dhe burimeve për kërkim dhe zhvillim në vend. Duke u mbështetur në këtë qëllim programi i studimit ndikon në zhvillimin e njohurive e kapaciteteve në fushën e marketingut ndërkombëtar në aspektet e transportit intermodal dhe parimeve të manaxhimit logjistik ndërkombëtar si një instrument i konkurrueshmërisë ekonomike në kohën e sotme.</p> <p>Vetë institucioni mbështet programin e studimit duke u përfshirë në bashkëpunime me institucionet publike, organizatat si dhe me aktorët lokalë e rajonal për kualifikim më cilësor, siç shprehet dhe në strategjinë e institucionit dhe vetë programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet me përfaqësues të Universitetit EPOKA, GVJ gjykon se formimi akademiko-shkencor i programit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik është në përputhshmëri me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i> <i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik synon formimin e studentëve lidhur me ndryshimet ciklike të ekonomisë, funksioneve manaxheriale si dhe praktikave të marketingut me profil ndërkombëtar. Krahas njohurive bazë formuese, ky program ofron një përafrim në sektorin logjistik kombëtar dhe ndërkombëtar. Logjistika ndërkombëtare është një instrument kyç konkurrueshmërie për biznesin në kohën e sotme. Në këtë pikëpamje, programi është jo vetëm kontribues, por edhe nxitës i përshtatjes së nevojave ekonomike me produktin akademik të institucionit.</p> <p>GVJ pas konsultimit të dokumentacionit bazë dhe vizitave në insitucion konstaton se programi është hartuar në përputhje me zhvillimet ekonomike kombëtare e ndërkombëtare dhe është me rëndësi strategjike për rritjen e bizneseve shqiptare ndërkombëtarisht.</p>

	<p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i> <i>Aneksi 26. Studimi i tregut të punës</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi 1.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.


Universiteti EPOKA ka hartuar dhe miratuar një Plan Strategjik për zhvillimin e institucionit, për periudhën 2018-2022. GVJ vlerëson se prioritetet strategjike janë

- Kërkimi shkencor (zhvillimi i aktiviteteve kërkimore; rritja e numrit dhe cilësisë së publikimeve; organizimi i aktiviteteve shkencore dhe promovimi i pjesëmarrjes; rritja e numrit të projekteve ndërdisiplinore).
- Cilësia akademike (rritja e cilësisë së të programeve; promovimi i kualifikimit të mëtjeshëm të stafit akademik; integrimi i programeve me programet e BE).
- Bashkëpunime institucionale (zhvillimi i bashkëpunimeve më universitetet në Shqipëri dhe jashtë; zhvillimi i bashkëpunimit me biznesin; fuqizimi i lidhjeve student-universitet pas diplomimit; fuqizimi i lidhjeve shoqëri-universitet).

Cilësia akademike, kërkimi shkencor, bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit, të cilat krijojnë një mjedis që promovon të mësuarin interaktiv dhe kërkimin shkencor në bashkëpunim me njësitë kombëtare e ndërkombëtare, në mënyrë që të nxisë kërkim zhvillimin në përputhje me misionin e IAL-së. Pjesë e prioriteteve është dhe përshtatja e vazhdueshme e kurrikulave dhe programeve me tregun e punës. Vlen të theksohet se programi i studimit Bachelor është në përputhje me Planin Strategjik të IAL-së. Ai është hartuar duke konsideruar sfidat e mëdha të mjedisit gjithmonë e më konkurrues, punëdhënësit si dhe shoqërinë në tërësi.

Plani strategjik, statuti, dhe rregullorja e IAL-së janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërvarura me njëra – tjetrën në kërkim të standarteve akademike e kërkimore, të kërkimit shkencor, mësimdhënies, vëmendjes ndaj studentëve, dhe mbështetjen për

	<p>nevojat e zhvillimit perspektiv të shoqërisë.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e brendshme të FEAS gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Universiteti EPOKA ka hartuar programin e studimit në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur efikasitetin institucionale. Statuti është dokumenti kryesor, prej të cilit hartohen rregulloret dhe procedurat e Fakulteteve dhe Departamenteve dhe organeve të tjera mbi bazën e të cilave zhvillohet e gjithë veprimtaria mësimore, shkencore dhe edukative në IAL.</p> <p>Programi Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 5. Rregullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik siguron njohuri në shkencat ekonomike, me fokus në funksionin e marketingut dhe të logjistikës për të përmirësuar cilësinë, aftësitë praktike, orientimin me tregun dhe kompetencat akademike e profesionale të studentëve të cilët përmes lëndëve bazë e me zgjedhje të programit plotësojnë njohuritë për nivelin bachelor me një përafrim në sektorin logjistik dhe orinetohen drejt thellimit në këtë fushë në nivelet më të larta të edukimit në të ardhmen.</p> <p>GVJ konstaton se programi Bachelor në emërtimin organizimin dhe strukturën është në përputhje me drejtimin akademik të institucionit në fushën e ekonomisë e biznesit, si pjesë e këtij fakulteti.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar Menaxhimit Logjistik 2021</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesi si njësi bazë që ofron këtë program studimi, krahas objektivave për ti shërbyer tregut dhe biznesit shqiptar, rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të standarteve të mësimdhënies, forcimit të marrëdhënieve me studentët, vlerëson formimin e studentëve të programit të studimit, me dije e kompetenca që i shërbejnë tregut dhe qëllimeve të institucionit.</p> <p>Cikli i parë i studimeve në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik synon formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut ndërkombëtar duke u siguruar njohuritë themelore në shkencën e marketingut të përshkallëzuara për nivelet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit.</p> <p>Në planin strategjik të institucionit, janë përcaktuar objektiva të programit të kategorizuara për kërkimin shkencor, rritjen e cilësisë së mësimdhënies, orientimin drejt biznesit, rritjen e kontributit në komunitet. GVJ konstaton <i>se objektivat për këtë program studimi janë të përgjithshme dhe nuk dallojnë nga objektivat për programet e tjera bachelor si p.sh bachelor në administrim biznes. Ato nuk diferencojnë qartë dijet, aftësitë dhe kompetencat që karakterizojnë këtë program studimi.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se ky program është në funksion të integritimit rajonal e global dhe duhet të shërbejë si bazë për studimet e mëtejshme më të thelluara në fushën e logjistikës ndërkombëtare.</i></p> <p>Në përfundim të programit të studimit, studentët kanë mundësi për të operuar në Shqipëri dhe globalisht në sajë të njohurive të integruara në lidhje me organizatat e orientuara ndërkombëtarisht.</p> <p><i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i></p>

	<p><i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar Menaxhimit Logjistik 2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga takimi me Drejtuesin e Departamentit të Administrim Biznesi dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, si dhe shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB të dorëzuar nga IAL, GVJ konstaton se nuk janë kryer studime tregu për këtë program specifik studimi. Krijimi dhe përmirësimi i programit është bazuar në raporte strategjike dhe hulumtime nga institucione publike dhe organizata ndërkombëtare lidhur me tregun e punës në Shqipëri.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit pranë Universitetit Epoka ka zhvilluar anketime për punësimin e të diplomuarve në Epoka ku janë evidentuar dhe nevojat e tregut të punës nga Alumni.</p> <p>Departamenti dhe sektori i Alumnit e Karrierës ka krijuar lidhje me biznese lokale dhe kombëtare duke ndihmuar në përshtatjen e të diplomuarve me tregun e punës. Vlerë e shtuar në këtë drejtim janë dhe eventet e aktivitetet e organizuara nga njësia dhe të pasqyruara në evidencën Annex 16.</p> <p><i>GVJ rekomandon të zhvillohen studime tregu post pandemisë për të vlerësuar programin e studimit dhe rishikuar qasjen kombëtare e ndërkombëtare të tij. GVJ sugjeron se njësia përgjegjëse e programit të studimit, në bashkëpunim me Sektorin e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës të përditësojë periodikisht punësimin real të studentëve të diplomuar dhe të ndjekë zhvillimet në sektorin përkatës përmes marrëveshjeve të ngushta me tregun e punës, të cilat shërbejnë si avantazh konkurrues i programit dhe si promotor i tij për brezat e ardhshëm.</i></p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit për avancimin e programeve të studimit në Administrim Biznesi 2020</i> <i>Aneksi 26. Studimi i tregut të punës</i> <i>Aneksi 27. Anketa e Alumni 2019-2020</i> <i>Aneksi shtesë 5. Evidenca mbi gjurmimin e ish studenteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive,</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik është i organizuar në tre vite akademike me lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje të vlerësuara me një total prej 180 kreditesh (60 kredite çdo vit), konform ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p>

shkathësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe vizitat në Institucion, GVJ konfirmon se

Programi i studimit është organizuar në 3 vite akademike, 6 semestra dhe 16 javë mësimore për semestër në auditor (këtu përfshihet dhe java e provimit përfundimtar).

- a. 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor (këtu përfshihet dhe java e provimit përfundimtar).
- b. 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor (këtu përfshihet dhe java e provimit përfundimtar).
- c. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- d. 1 orë mësimore = 50'

Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik pajisen me diplomë "Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik".

Në planin mësimor të gjitha modulet janë të vlerësuara me 5 dhe 6 ECTS dhe si formë mësimdhënie është parashikuar leksioni dhe seminari.

Numri i orëve në auditor për një kredit nuk është bërë në përputhje me Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 të Ministrit të Arsimit.

Një krediti nuk i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.

Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.


Orët për punë të pavarur të studentit duhet të zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.

Në këtë program studimi vëmëndje i është kushtuar përmbajtjes së kurrikulës dhe cilësisë së përmbajtjes së ofruar për të siguruar formimin dhe kopetencat e kërkuara nga bizneset kombëtare dhe ndërkombëtare. Lëndët karakterizuese dhe me zgjedhje janë shtuar për të garantuar përftimin e dijeve dhe kompetencave të profilit marketing. Siç u njohëm nga takimi me përgjegjësën e njësisë së programit të studimit dhe stafit, këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e nevojës për thellim të njohurive praktike e teorike të studentëve në formim në fushën specifike dhe për lehtësim të

	<p>punësimin të tyre.</p> <p>GVJ konstaton se program i studimit përmbush objektivin kryesor të formimit të specialisteve të aftë për të punuar në marketing dhe realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.</p> <p><i>GVJ sugjeron një rishikim të lëndëve të formimit karakterizues, duke theksuar se lëndët e profilit marketing duhet të garantojnë përftimin e dijeve dhe kompetencave aktuale të profilit. Për këtë nevojitet të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së lëndëve si Marketing Dixhital, Menaxhim i forcës së shitjes, Menaxhim i kanaleve të shpërndarjes, Menaxhim global i logjistikës, Prokurimi Ndërkombëtar, Inovacioni etj të detyrueshme në program.”</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që praktika mësimore të kenë një peshë më të madhe në programin e studimit me qëllim aftësimin e studentëve në tregun e punës.</i></p> <p><i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i> <i>Aneksi 11.2 Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit.</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhimin Logjistik 2021</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1198 826 1265">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="826 1198 1026 1265">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1026 1198 1230 1265">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="550 1265 826 1310"></td> <td data-bbox="826 1265 1026 1310" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1026 1265 1230 1310"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti Epoka ka përvijën dhe kapacitetin në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit. Ky program ofrohet nga Departamenti i Administrimit Biznesit, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative i cili nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Në statutin dhe rregulloren e universitetit dhe fakultetit gjëjmë mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative të institucionit. Hartimi i programit bachelor vë në efikasitet burimet</p>


	<p>njerëzore të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative pasi integron stafin e departamenteve të tjera me qëllim marrjen e njohurive dhe kompetencave bazë në administrim biznes dhe plotësimin e profilizimit në marketing.</p> <p>Sipas të dhënave të tre viteve të fundit të personelit akademik të për programin e studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik numri i personalit PAE ka ardhur duke u ulur ndjeshëm. Aktualisht në vitin akademik 2021-2022 programi përbëhet nga 16 PAE ku 3 mbajnë titullin “Profesorë të Asociuar”, 6 mbajnë gradën Dr. dhe 7 Asistent Lektorë (Msc.), dhe 4 PAK. Ndryshimet në numrin e personelit PAE gjatë tre viteve të fundit tregojnë mungesë qëndrueshmërie në burimet e programit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe takimet me stafin u vu re një rekrutim i ulët i stafit të ri, i argumentuar me mungesën e stafit të kualifikuar në treg.</p> <p><i>Nga evidencat e shqyrtuara, GVJ tërheq vëmendjen se mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik realizohet nga personel akademik i pakualifikuar dhe i angazhuar në mësimdhënie në mungesë të gradave dhe titujve akademikë. Njësia bazë ka mungesë të burimeve njerëzore të kualifikuara për këtë program studimi.</i></p> <p><i>Aneksi 67.1 Skema Organizative e Universitetit EPOKA</i> <i>Aneksi 73. CV-të e stafit</i> <i>Aneksi shtesë 7.Tabela 4_BA IML Ngarkesa Mësimore_Fall 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Universiteti EPOKA vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton ligjin e Arsimit të Lartë në fuqi (L.80/2015 Neni 23 pika 1) dhe përcaktimet statutoare. Strukturat janë të formuara që të garantojnë arritjen e misionit të EPOKA në pëmbushje të autonomisë akademike.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik i përket nivelit 6 të kornizës shqiptare të kulifikimeve, në fushën e shkencave ekonomike me drejtim specifik në Marketing.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me stafin akademik u pohua se personeli është nxitur të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferenca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfituar edhe mbështetje financiare përmes akordimit të granteve kërkimore.</p> <p>GVJ konstaton se njësia ka konsoliduar strukturën e kërkimit shkencor dhe zhvilluar objektivat e kërkimit në përputhje me</p>



	fushën përkatëse të formimit të specifikuar dhe në Planin Strategjik të institucionit 2017-2022. <i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i>		
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik është i organizuar në tre vite akademike me një total prej 180 kreditesh (60 kredite çdo vit) me kohë të plotë Programi i Studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të vendosur nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. GVJ konstaton se fusha specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Administrim Biznesit. <i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 67.1 Skema Organizative e Universitetit EPOKA</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik, Departamenti i Administrim Turizëm si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar stafin. Lëndët karakterizuese të programit mbulohen nga stafi i Departamentit, ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative për lëndët e formimit bazë dhe lëndë me zgjedhje. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të Universitetit Epoka duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC. Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësisë në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e IAL-së. <i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategjia dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i>

	<p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 11.2 Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, Universiteti EPOKA ka nënshkruar marrëveshje kombëtare e ndërkombëtare me palët e treta, institucione e biznese për shkëmbim ekzpertize në funksion të procesit mësimor dhe realizimin të objektivave të programit të studimit. GVJ i janë vënë në dispozicion marrëveshjet e bashkëpunimit të cilat u japin mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale dhe aktivitete të tjera të përbashkëta. Gjithashtu Universiteti EPOKA ka krijuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe edhe jashtë vendit përmes programit Erasmus+ me objekt shkëmbimin e burimeve njerëzore dhe ndërtimin e programeve të reja të studimit.</p> <p>Bazuar në evidencën 15, Universiteti EPOKA numëron 44 marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione jo akademike, dhe 98 marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike për të realizuar objektivat e përcaktuara në procesin mësimor.</p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në fund të vitit akademik, Departamenti i Administrim Biznesit bën analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku përveç aspekteve të tjera të punës për mbarëvarjtjen e programit të studimit, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera.</p> <p>Departamenti ka hartuar relacion në Evidencën 16 për përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.</p> <p><i>GVJ konstaton se mungojnë analiza mbi përfitimet konkrete të realizimit të praktikave profesionale dhe përmirësimet që duhet të bëhen në të ardhmen.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron një angazhim më të madh të Zyrës së Karrierës dhe Njësisë përgjegjëse për të rritur peshën dhe kohëzgjatjen e praktikës mësimore në planin mësimor të programit dhe rritje të trainimeve të studentëve për mënyrën e kërkimit të punësimit dhe specializimit të mëtejshëm për këtë program studimi.</i></p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit për avancimin e programeve të studimit në Administrim Biznesi 2020</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e</p>	<p>Universiteti EPOKA ka vendosur në dispozicion të GVJ dokumentin me institucione e kompani në të cilat studentët e</p>



<p>bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>programit Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik kanë mundësi të zhvillojnë praktikën e tyre. Procesi mbikëqyrës nga Departamenti në bashkëpunim me pedagogun mbikëqyrës të praktikës.</p> <p>Studenti e zhvillon praktiken në semestrin e 6-të, dy javë mësimore. GVJ u njoh me procedurën e mbikëqyrjes së praktikës në vizitën në institucion, ku 44 marrëveshjet e nënshkruara me institucione e biznese janë një bazë e mirë e realizimit të praktikave dhe punësimit të ardhshëm të studentëve.</p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit për avancimin e programeve të studimit në Administrim Biznesi 2020</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Logjistik synon të zhvillojë shprehitë, kompetencat dhe aftësitë e studentëve në marketingun dhe funksionin e logjistikës së bizneseve. Departamenti i Administrim Biznesit është i angazhuar për trajtime të mëtijshme profesionale në funksion të programit të studimit, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni, Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm, Qendra Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri, Qendra e Kërkimit Shkencor dhe Dizajnit në Shkencat e Aplikuara . GVJ u informua lidhur me aktivitetet dhe trainimet e zhvilluara përmes Evidencës 28.</p> <p><i>GVJ konstaton se programet e trajnimit të vazhduar nuk janë të zhvilluara posaçërisht për këtë program studimi.</i></p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>Aneksi 28. Aktivitete trajnuese për Stafin Akademik</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	------------------------------	---	------------------------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” që ofrohet nga Universitetit “EPOKA” është një program tre vjeçar, i cili përputhet plotësisht me strukturën e sistemit të Bolonjës. Programi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, i cili përbëhet nga:

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financë- Bankës
- Departamenti i Administrim Biznesit.

Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”, pjesë e Departamentit të Administrim Biznesit, është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (UMASH), Nr. 222, datë 31.05.2013, në bazë të Vendimit të Këshillit të Akreditimit nr. 476, datë 03.05.2013.

Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” e regjistruar me Urdhër Nr. 14, datë 19.01.2017 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

GVJ gjykon që Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” plotëson në tërësi kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, rritjes së kërkesës për profesionistë në fusha të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, organizimit dhe administrimit me një staf të kualifikuar, mësimit dhe mësimit me një staf të cilësi të programit të studimit. Sidoqoftë, argumentimi nga drejtuesit e njësive, mbi përparësitë e këtij program, mbase i vetmi i këtij lloji në vendin tonë, nuk mbështetet në evidenca dhe të dhëna, që dëshmojnë për nevojën e tregut shqiptar për specialistë të fushës së mësipërme.

Programi i studimit përbëhet nga:

Viti 1, Semestri 1 dhe 2 (60 ECTS, të gjitha lëndë të detyrueshme), përkatësisht:

Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (7 lëndë/35 ECTS),
Lëndë Karakterizuese (3 lëndë /15ECTS),
Lëndë plotësuese (2 lëndë/10 ECTS).

Viti 2, Semestri 3 dhe 4 (60 ECTS, 45 ECTS nga lëndë të detyrueshme dhe 15 ECTS nga lëndë me zgjedhje), përkatësisht:

Lëndë Karakterizuese (8 lëndë /40ECTS),
Lëndë ndërdisiplinore (2 lëndë/10ECTS),
Lëndë plotësuese (2 lëndë, me zgjedhje nga 14 alternativa/10 ECTS).

	<p>Viti 3, Semestri 5 dhe 6 (60 ECTS, 43 ECTS nga lëndë me detyrim, 11 ECTS nga lëndë me zgjedhje dhe 6 ECTS detyrime përmbyllëse), përkatësisht: Lëndë Karakterizuese (4 lëndë /20ECTS dhe 3 lëndë/18ECTS, gjithsej 7lëndë/38ECTS), Lëndë ndërdisiplinore (1 lëndë/5ECTS), Lëndë karakterizuese ose ndërdisiplinore me zgjedhje, nga 10 alternativa (1lëndë /5ECTS dhe 1 lëndë /6ECTS, gjithsej 2 lëndë /11ECTS). Detyrime përmbyllëse, 6 ECTS.</p> <p>Nisur nga pesha specifike e grup lëndëve ndaj totalit si edhe të atyre me zgjedhje në raport me ato të detyrueshme, GVJ gjykon që kriteret dhe standartet e përcaktuara respektohen.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.pdf; Vizita në institucion; Urdhër Nr. 222 datë datë 31.05.2013, ams.ascal.al; Vendim Nr. 476, datë 03.05.2013, ams.ascal.al; Urdhër Nr. 14, datë 19.01.2017, ams.ascal.al; http://eis.EPOKA.edu.al/curricula; Aneksi 12. KurriKula e programit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon që programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t’iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit, i cili është një nga institucionet më të njohura në vend dhe i vetëm në llojin e tij.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” i ofruar prej vitit 2013, synon të ofrojë njohuri në fushën e marketingut dhe logjistikës për studentët në mënyrë që ata të mund të jenë individë të trajnuar mirë, të gatshëm për tregun e sotëm të punës, i cili është shumë konkurrues. Nëpërmjet këtij program studimi, studentët aftësohen në analizën e çështjeve të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët, marketingut ndërkombëtar, sjelljeve të konsumatorit dhe logjistikës, si edhe aplikimit të tyre në treg nga kompanitë. Për të përbushur misionin e departamentit dhe për të pajisur studentët me një status profesional, programi i studimit iu siguron studentëve njohuri në menaxhim, administrim biznesi dhe vecanërisht të fushës së marketingut për t’i shërbyer sektorit</p>

	<p>publik dhe atij privat.</p> <p>Pavarësisht misionit dhe qëllimit, të formuluar në dokumentat themelore të njësisë bazë, konstatohet se studentëve iu ofrohen vetëm 2 lëndë nga fusha e Logjistikës dhe vetëm 3 lëndë nga fusha e marketingut, përkatësisht: Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, Menaxhimi strategjik i Logjistikës, Baza Marketingu, Kërkim Marketing dhe Marketing ndërkombëtar. Njësia duhet të ofrojë më shumë informacion dhe evidenca mbi zgjedhjen e këtij program si edhe argumentimin e përpunueshmërisë së tij me kërkesat e tregut shqiptar.</p> <p><i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion;</i> http://eis.EPOKA.edu.al/curricula; <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ gjykon që programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” është program bashkëkohor, i hartuar me një mentalitet të orientuar drejt tregut, në mënyrë që t’i shërbejë bizneseve dhe shoqërisë duke përballuar kërkesat në rritje dhe dinamizmin e tregut, si edhe integritet të vendit në ekonominë rajonale, europiane dhe globale.</p> <p>GVJ konstaton se ofrimi i njohurive të thelluara dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet programit që vlerësohet, është vlerë e shtuar për dy arsye. Së pari, përkon me tendencën bashkëkohore të hulumtimit në fushën e Logjistikës dhe të rolit të saj në menaxhimin efektiv të organizatave dhe aktiviteteve të tyre. Së dyti, synon të ndërgjegjësojë mjedisin e biznesit shqiptar mbi rolin e Logjistikës, një komponent tërësisht i pavlerësuar në kulturën shqiptare, ende të paformuar, të ekonomisë së tregut. Pavarësisht kësaj, GVJ rikonfirmon gjykimin se program ekzistues, pavarësisht përputhjes së tij me kuadrin ligjor vendas dhe të BE, nuk arrin të përçojë qëllimin dhe objektivat e tij, sepse nuk argumentohet qartë lidhja ndërmjet Menaxhimit Logjistik dhe Marketingut Ndërkombëtar, si edhe nuk mbështetet informacioni i synuar me materialin teorik që ofron programi.</p> <p><i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion;</i> http://eis.EPOKA.edu.al/curricula; <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për</p>	<p>GVJ konstaton se programi Bachelor që vlerësohet ofron njohuri të përparuar në fushën e studimit, përfundim i cili mbështetet nga pesha e lëndëve të disiplinave karakterizuese (50 deri 55%) si edhe nga larmishmëria e tyre. Lëndët karakterizuese përfshijnë</p>

<p>zgjidhen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>thujtë të gjitha fushat të cilat garantojnë menaxhimin efektiv të Marketingut dhe të Logjistikës, pa mohuar vlerën e komenteve të formuluar tek kriteret e mësipërme.</p> <p>Të njëjtin këndvështrim vlerësues kanë edhe studentët e regjistruar në këtë program. Lëndët e përfshira në këtë program, përmbajtja e tyre si edhe metoda e mësimdhënies sigurojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të Marketingut Ndërkombëtar dhe të Menaxhimit Logjistik, e cila përforçohet nga marëdhëniet e gjera ndërkombëtare të universitetit, nga eksperiencat e larmishme, nga prania e profesorëve të huaj, nga pjesëmarrja në leksione e të ftuarve, si nga fusha akademike ashtu edhe nga organizatat publike dhe operatorët e biznesit.</p> <p><i>Aneksi 1. Mendimi i Dekanit</i> <i>Aneksi 2. Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimtimit 2018-2022</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.pdf Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i ciklit të parë që vlerësohet synon formimin e shprehive të veçanta në një profesion relativisht të të panjohur, por me një lidhje të fuqishme dhe harmonike me administrimin në përgjithësi dhe administrimin e biznesit, në veçanti.</p> <p>GVJ gjykon që njësia kryesore është e paisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë me sukses objektivat e saj në lidhje me programin, duke zhvilluar dhe ofruar njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushat akademike dhe profesionale të renditura më lart.</p> <p><i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i> http://eis.EPOKA.edu.al/curricula <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit i ciklit të parë, që vlerësohet, respekton me rreptësi strukturën e programit të studimit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Informacioni i detajuar mbi përbërjen e programit paraqitet tek analiza e standartit sipas kriterit 2.</p> <p>Siç rezulton nga llogaritjet, konstatohet se: Disiplina të formimit të përgjithshëm përbëjnë 19%; Lëndë Karakterizuese 52%, Lëndë ndërdisiplinore, 14%; Lëndë plotësuese, 12% dhe Detyrime përmbyllëse, 3%. Praktika zë gjithashtu 3% të programit, por është pjesë e grupit “Lëndë plotësuese”.</p> <p>GVJ konfirmon se programet e studimit jo vetëm kanë të përcaktuara qartë veprimtaritë e tyre, gjë e cila konstatohet tek përshkrimi i detajuar i moduleve, por edhe zbatimi i tyre</p>

	<p>vëzhgohet me kujdes nga njësia me qëllim pasqyrimin e zhvillimeve bashkëkohore.</p> <p><i>RVB Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i> http://eis.EPOKA.edu.al/curricula <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti Epoka është një institucion privat i arsimit të lartë, që e filloi aktivitetin akademik gjatë vitit akademik 2007-2008 në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar të arsimit të lartë. Në vitin 2012, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 553, datë 22.08.2012, statusi ligjor i institucionit ndryshoi nga “Institucioni i Arsimit të Lartë” në “Universitet”.</p> <p>Universiteti Epoka përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i përbërë nga Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, i përbërë nga Departamenti i Bankave dhe Financave, Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Departamenti i Ekonomisë; Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale i përbërë nga Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Qendra për Studime Evropiane.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” ka marrë akreditimin e parë bazuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit 155, datë 16.05.2016.</p> <p>Njësia kryesore bazë, ofruese e programit që vlerësohet për riakreditim, saktësisht programi “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” ka dorëzuar dosjen e vlerësimit, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Dosja përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Njësia gjithashtu ka organizuar dhe lehtësuar vizitën në institucion, duke vënë në dispozicion stafin drejtues, akademik dhe operacional, si edhe ambientet për një zhvillim normal të procedurës së vlerësimit. Dokumentacioni themelor është ofruar në gjuhën angleze, gjuha e punës e</p>

	<p>institucionit si edhe shqip. GVJ gjykon se njësia bazë i kushton vëmendje të veçantë dokumentacionit që rregullon veprimtarinë akademike dhe operacionale të institucionit. Njësia kryesore bazë i përmbush të gjitha detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.</p> <p><i>Aneksi 1. Mendimi i Dekanit</i> <i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Njësia kryesore i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së dokumentacionit i cili udhëheq veprimtarinë e institucionit. Shqyrtimi i dokumentacionit të Njësisë bazë, veçanërisht i Statutit dhe Rregullores së departamentit, konfirmoi se njësia bazë ka realizuar detyrimin për të caktuar një koordinator programi, përfshirë edhe listën e detyrave përkatëse.</p> <p>Mbështetur në Statutin e universitetit (Aneksi 2) si edhe Rregullore e FEAS (Aneksi 6) konstatohet se njësia kryesore përgjegjëse për programin që vlerësohet, cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e programit dhe praktikave në përputhje me objektivat e departamentit dhe fakultetit.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit BA në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik punon nën mbikqytjen e Përgjegjësit të Departamentit të Administrim Biznesit dhe njëkohësisht ka mbështetjen e departamentit në fjalë.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.pdf;</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Administrimit të Biznesit i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative ofron programin e nivelit të parë, Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik, i cili është në process vlerësimi për riakreditim. Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” në Universitetin “EPOKA” u licencua bazuar në Urdhryn nr. 222, datë 31.05.2013, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Më tej, në bazë të Urdhrit nr. 155, datë 16.05.2016, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, u përfundua me sukses procesi i akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”.</p> <p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin si edhe gjerësisht diskutoi me stafin akademik dhe drejtuesit e Njësisë Bazë, gjykon që Njësia</p>

	<p>bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Struktura akademike përputhet plotësisht me misionin, qëllimin dhe objektivat e Programit që vlerësohet. Organizimi i saj mbështet plotësisht aktivitetin akademik si edhe operacional. Informacion më i detajuar jepet tek analiza e standartit sipas kriterit 4.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Tabelat përmgledhëse RVB (Tabelat 1,2,3,4 dhe 5)</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.pd</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Sipas të dhënave (Lista e plotë e personelit 2021-2022, stafi i njësisë bazë përbëhet nga 26 pedagogë me kohë të plotë dhe 10 pedagogë me kohë të pjeshme. Nga lista e pedagogëve efektivë, 7 pedagogë janë të kategorisë Profesor (3 anëtarë me titull Prof. Dr. dhe 4 anëtarë me titullin Prof. Asoc. Dr.), 9 pedagogë me gradën Doktor Shkencash, dhe 10 anëtarë me gradën Master i Shkencave. Këta pedagogë janë të organizuar në 3 departamente, përkatësisht 7 pedagogë në Departamentin e Ekonomiksit, 9 pedagogë në Departamentin e Financë Bankës dhe 10 pedagogë në Departamentin e Administrim Biznesit.</p> <p>Stafi me kontratë (10) përbëhet nga 2 Prof. Asoc. Dr, 2 Dr dhe 6 MSc. Stafi me kontratë kryesisht është i aktivizuar në departamentin e Financë bankës (8) dhe vetëm 2 pedagogë ushtrojnë profesionin në Departamentin e Administrim Biznesit.</p> <p>Programi “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” realizohet nga 10 pedagogë efektivë të Departamentit nga I cili buron programi, nga të cilët 3 janë të huaj, si edhe 2 pedagogë me kohë të pjeshme. Stafi efektiv përbëhet nga 3 (30%) Prof.Dr dhe Prof. Asoc.Dr, 4 (40%) Dr dhe 3(30%) MSc.</p> <p>Programi “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” për vitin akademik 2021-2022 realizohet nga 18 pedagogë PAE dhe 4 PAK, nga të cilët 10 pedagogë PAE dhe 2 pedagogë PAK, janë staf i Departamentit të Administrim Biznesit, nga i cili buron programi që vlerësohet.</p> <p>Sipas tabelës 7.2 të RVB, 5 pedagogë (3 PAE dhe 2PAK) janë të kategorisë Prof.As.Dr; 6 pedagogë (PAE) janë të kategorisë Dr/PhD; 4 Asistentë lektorë janë të kategorisë Msc në proces doktore (PAE) dhe 7Asistentë pedagogë (5 PAE dhe 2PAK) janë të kategorisë Msc, të grup moshës 25 – 35 vjeç. GVJ gjykon që raporti ndërmjet PAE/PAK, përkatësisht 4.5/1 është një raport i</p>

	<p>pranueshëm. 50% e stafit janë pedagogë të kualifikimit të lartë, me gradë Dr/PhD dhe Prof.As.</p> <p>Njësia motivon ish studentët, të cilët jo vetëm janë diplomuar me rezultate të larta, por kanë demonstruar qartë interesin e tyre për të zhvilluar karrierë akademike, nëpërmjet përfshirjes në studime doktorale, pjesëmarrjes në projekte kërkimore, prezantimit dhe botimit të rezultateve kërkimore. Pezullimi i përkohshëm i programeve doktorale ka penguar kandidatët për të përfunduar studimet e tyre.</p> <p>GVJ gjykon që struktura akademike përputhet me misionin, qëllimin dhe objektivat e njësisë. Gjithashtu edhe struktura operacionale përputhet. Megjithatë GVJ konstatoi se personeli ndihmës akademik ka ndryshuar ndjeshëm në vitin akademik aktual në krahasim me një vit më parë, përkatësisht nga 7 ndihmës akademikë në asnjë, fakt për të cilin, njësia nuk siguroi shpjegim të qartë dhe të argumentuar.</p> <p>Sidoqoftë GVJ sugjeron se duhet të rritet numri i PAE me grada dhe tituj si kusht për mësimdhënie në programin e studimit dhe zhvillimin e kopentencave kërkimore-shkencore të tij, për më tepër që stafi mësimdhënës i programit të studimit i takon masivisht kategorisë së moshës 25-35 vjeç dhe mban statusin pedagog pa tituj akademikë. Njësia bazë ka mungesë të burimeve njerëzore të kualifikuara për këtë program studimi.</p> <p>GVJ rekomandon që IAL të përmirësojë procesin e rekrutimit të personelit akademik me grada dhe tituj konsideruar objektivat kërkimore-shkencore të programit por edhe të IAL-së në tërësi.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Tabelat përmgledhëse RVB (Tabelat 1,2,3,4,5 dhe 7.2)</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.pd</i> <i>Vizita në institucion</i></p>						
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shih më sipër, kriteri 3</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="563 1709 810 1765">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="810 1709 1026 1765">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1026 1709 1246 1765">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="563 1765 810 1814"></td> <td data-bbox="810 1765 1026 1814" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1026 1765 1246 1814"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi II.3
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Siç rezulton nga dokumentat themelore rregullatore të hartuara nga institucioni dhe njësia bazë, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (UMASH), Nr. 222, datë 31.05.2013, në bazë të Vendimit të Këshillit të Akreditimit nr. 476, datë 03.05.2013).</p> <p>Njësia Kryesore, Departamenti i Administrim Biznesit, përgjegjës për programin Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik, disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprore institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.</p> <p>Legjislacioni udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave) për veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, analizohet në Rektorat dhe mbi këtë bazë, hartohen dokumentat kryesore rregullatore në nivel universiteti dhe fakulteti. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijnë të protokolluara (koduara) dhe sipas afateve nga senati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet.</p> <p>Rregullorja e brendshme e fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, është miratuar nga Senati, ndërsa zbatimi i saj është përgjegjësi e Rektorit. Rregullorja është një dokument i plotë, i përbërë nga 81 nene, që rregullojnë veprimtarinë e të gjithë institucionit, si në planin akademik, ashtu edhe operacional, si në ambientin e brendshëm, ashtu edhe në ambientin e jashtëm të realizimit të veprimtarisë. Megjithatë, GVJ konstatoi se në dokument mungon data e miratimit si edhe numri i protokollit/kodi.</p> <p>Njësia bazë nuk ka përpunuar rregullore të veçantë sepse gjykohet e mjaftueshme rregullorja e fakultetit. Por, institucioni ka përpunuar edhe disa dokumenta të tjerë, që përcaktojnë marrëdhëniet institucionalesë pari me studentët dhe detyrimet e tyre për ndjekjen e studimeve dhe realizimin e provimeve (Aneksi 7), si edhe Planin Strategjik të Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022 (Aneksi 4). Edhe këto dokumenta, ndonëse iu mungon data dhe numri i protokollit, janë miratuar në Senat, siç gjykohet nga vula.</p> <p>Institucioni ka përgatitur dhe përdor edhe dokumenta të tjerë të cilët synojnë zhvillimin e programeve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e nivelit profesional, rritjen e cilësisë si edhe vëzhgimin e veprimtarisë në raport me arritjen e</p>

	<p>objektivave akademike dhe institucionale. Konstatohet se njësia bazë i njeh dhe i përdor këto dokumenta, të cilat i shërbejnë si udhërrëfyese në aktivitetin e saj.</p> <p>GVJ konstaton se ndonëse njësia bazë qartësisht i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni, disa dokumenta rregullatore nuk janë të protokolluara, data e miratimit nuk është e përcaktuar, ndërsa vërehet edhe mungesë e evidencave mbi diskutime në departament.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i> <i>Aneksi 5. Rregullorja bazë e Universitetit EPOKA</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet dhe provimet universitare"</i> <i>Shtojca 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë.</i> <i>Aneksi 11.2 Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.pdf;</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të paraqitura tek "Dosja e plotë e hapjes së programit, Plani mësimor 2021-2022, si edhe Rregullorja e Programit), lehtësisht konstatohet rëndësia dhe vëmendja që i kushton departamenti formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga "Disiplina të formimit të përgjithshëm, (kategoria A), 7 lëndë/35 ECTS ose 19%, Lëndë Karakterizuese (kategoria B), 18 lëndë/93ECTS ose 52%, Lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese si edhe me zgjedhje (kategoria C), 5 lëndë/26ECTS ose 14%, Lëndë Plotësuese (kategoria D), 4 lëndë/20ECTS, ku është e përfshirë edhe Praktika profesionale mësimore, 5 ECTS ose 12% (Praktika 3%), si edhe Detyrime Përmbyllëse (kategoria E), 6ECTS ose 3%, gjithsej 180ECTS.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në përputhje me specifikimet ligjore.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Tabelat përmbëdhëse (Tabelat 1,2,3,4 dhe 5)</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module,</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Marketing Ndërkombëtar dhe</p>

<p>të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Menaxhim Logjistik”, bazohet në sistemin e vlerësimit me kredite ECTS, sistem i cili është pranuar gjerësisht në nivel Europian dhe në nivel kombëtar, në përputhje me kartën e Bolonjës, duke krijuar mundësinë e krahasimit të ngarkesës së nevojshme për realizimin e secilës lëndë që përbën një program studimi.</p> <p>Programi i studimit realizohet në 3 vite akademike ose 6 semestra me një total prej 180 ECTS, 60 ECTS per secilin vit akademik. Një semester përmban 15 jave mësimore ose 30 ECTS.</p> <p>Kreditet e secilës lëndë së bashku me peshën specifike të grup lëndës (përqindja ndaj totalit) ndihmojnë studentin të kuptojë ngarkesën e përgjithshme, vjetore dhe atë semestrale.</p> <p>Ai gjithashtu pasqyron kriteret për kalimin e të gjitha provimeve si edhe instrumentin për të vëzhguar ecurinë e studentit nga një vit akademik tek tjetri, deri në përfundimin e plotë të studimeve. (Planet Mësimore si edhe Rregullorja e Fakultetit).</p> <p>Konkretisht ndarja në semestra konsideron një shpërndarje relativisht të barabartë të ngarkesës mësimore, ku lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinate dhe plotësuese kanë nga 5 kredite secila, që nga Semestri i parë deri tek i pesti (përfshirë edhe semestrin e pestë). Vetëm lëndët e semestrit të gjashtë kanë nga 6 kredite, si edhe punimi i projektit të diplomës ose provimi përfundimtar.</p> <p>Lëndët dhe shpërndarja e tyre me kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë modulet e kategorive të ndryshme janë në zbatim të Vendimit nr 41, date 24.01.2018, udhëzimeve të MASR dhe rregulloreve të institucionit dhe programit.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Tabelat përmbëdhëse (Tabelat 1,2,3,4 dhe 5)</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” është i mbështetur në Planin Strategjik të Universitetit dhe të Fakultetit, 2017-2022 si edhe në Planet mësimore vjetore. Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60ECTS) është llogaritur 1,500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% (860 orë) përfaqësojnë punë të pavarur.</p>

	<p>Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e universitetit dhe të fakultetit (standardet bazë), janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>Syllabuset, 2018-2019; 2019-2020; 2021-2022</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Njësia Bazë ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat ju përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë: Rregullorja e studimeve në Bachelor dhe provimeve, Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Administrative Departamentit, Rregullorja e brendshme e studimeve e Fakultetit si edhe Statuti I Universitetit Epoka.</p> <p>Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marrëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Bachelor në marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</p> <p>GVJ gjykon që vlen për t'u nënvizuar vëmendja e institucionit në raport me procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Njësia bazë është kujdesur që programi i studimit të jetë i krahasueshëm me programe të tjera të së njëjtës natyrë, brenda dhe jashtë vendit, pavarësisht ndërtimit specifik të këtij programi, me qëllim që të lehtësojë ekuivalentimin dhe transferimin e studimeve, në përputhje me kërkesën e studentëve. Me vlerë është edhe dokumenti "Udhëzues për transferimin e studimeve", që përcakton procedurat dhe parimet e transferimit të studimeve nga institucioni dhe për në institucion, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja e studimeve në Bachelor dhe provimeve</i> <i>Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022</i> <i>Aneksi 60. Udhëzues për transferimin e studimeve</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik</i> <i>Vizita në institucion</i></p>



<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve të vitit 2021-2022 dëshmon për praninë e të gjithë komponentëve të domosdoshëm të informacionit mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit. Ky informacion është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t’u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve dhe literaturën. Formatet e syllabuseve përputhet me standartet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e parë të mësimi.</p> <p>Tek dosja e vlerësimit dorëzuar nga njësia bazë janë përfshirë edhe syllabuset e dy viteve të mëparshme, përkatësisht 2018-2019 dhe 2019-2020.</p> <p>GVJ konstatoi se mungon syllabusi I kursit për vitin akademik 2020-2021. Gjithashtu u konstatua se edhe pse dy syllabuset e përfshira në dosjen e vlerësimit, përkatësisht për vitin 2018-2019 dhe 2019-2020, janë të plota në ndërtim dhe informacion, mungon data e vitit akademik përkatës, ndërsa data e kodimit të syllabuseve të të dy viteve të mësipërme është e njëjtë, “EU-FRM-010-004-EN Pub. Date: 13/11/2019 Upd: 02”. Njësia bazë duhet të sigurojë informacion shpjegues mbi këtë detaj si edhe të plotësojë kërkesën për dërgimin e syllabuseve të vitit të munguar.</p> <p><i>Syllabuset, 2018-2019; 2019-2020; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Njësia bazë i kushton vëmendje të pandërprerë përmirësimit të programeve të studimit, si edhe përditësimit të tyre në përputhje me kërkesat bashkëkohore. Këtij qëllimi i shërben hartimi, miratimi dhe përdorimi i dokumentit “Politika e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve studimore”, në fuqi që nga viti 2018.</p> <p>Gjithashtu njësia bazë njih dhe përdor procedurën e kërkesës për ndryshime të përmbajtjes së programit, për të cilën ka organizuar një procedurë të institucionalizuar, ndonëse nuk e ka përdorur, sepse ka gjykuar që përmbajtja ekzistuese e programit plotëson kërkesat e legjislativës, të misionit të institucionit, të studentëve dhe të tregut.</p> <p><i>Aneksi 22.1. Procedura e ndryshimit të programit.</i> <i>Aneksi 22.2. Forma e propozimit për ndryshim të programit.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	Djesisht	kryesisht	plotesisht
		X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë, në nenin 70 pika 4, përcakton mënyrën e organizimit të programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, në tre cikle të njëpasnjëshme.</p> <p>Statuti i Universitetit Epoka dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative konfirmojnë se institucioni ofron programe studimi në tre cikle. Ngarkesa e programit në ciklin e parë përmban 180 kredite të shtrira përgjatë tre viteve akademike, në 6 semestra, përkatësisht dy semestra në një vit akademik.</p> <p>Ngarkesa në orë mësimore dhe orë jashtë auditorit është përcaktuar tek Plani Mësimor i programit, Shtojca 12 “Kurrikula e Programit të Studimit”.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2021-2022, referuar “Lista e personelit akademik që është i përfshirë në zhvillimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik" gjatë vitit 2021-2022” (Tabela 12.6) janë planifikuar të realizohen 1.408 orë gjithsej në auditor nga stafi PAE dhe PAK. Ndërsa stafi PAE do të realizojë 1264 orë ose 90% të ngarkesës së përgjithshme, stafi PAK do të realizojë 144 orë ose 10% të ngarkesës së përgjithshme.</p> <p>GVJ konstatoi se të dhënat e tabelës 10.5 nuk përputhen me të dhënat e tabelës 13, tek e cila rezultojnë 1.808 orë gjithsej në auditor. Njësia duhet të saktësojë të dhënat.</p> <p><i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Tabelat Përmbledhëse.</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programin që po vlerësohet, Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore dhe me zgjedhje, Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike, në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimit të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.</p>

	<p>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodatat e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues.</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve, lektorët e huaj të ftuar, të cilët kanë vijuar të jenë të pranishëm nëpërmjet leksioneve të hapura, edhe gjatë pandemisë (online) dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës. Praktikatat mësimore, të mbështetura nga njësiat kanë ndikuar në lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga auditorët në tregun e punës, ndonëse një studim i mirfilltë tregu mungon.</p> <p>Njësiat ka marëdhëniet bashkëpunimi të institucionalizuara nëpërmjet marrëveshjeve me 44 operatorë biznesi.</p> <p>GVJ konstatoi se njësiat konsideron parësore marëdhëniet e bashkëpunimit me institucione akademike si edhe jo akademike. Këto bashkëpunime e ndihmojnë njësinë për të rritur efektivitetin e procesit akademik në institucion, si edhe për të ndihmuar familiarizimin e studentëve me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Aneksi 15. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit. RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik. Tabelat Përmbledhëse. Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënies dhe aftësisht profesional.</p>	<p>Siç konstatohet nga Plani Mësimor si edhe nga diskutimet në institucion, shpërndarja e lëndëve ndërmjet viteve dhe semestrave synon të ofrojë njohuri gradualisht të përshkallëzuara. Kështu, në vitin e parë dhe pjesërisht në vitin e dytë ofrohen kryesisht disiplinat e njohurive të përgjithshme dhe karakterizuese, ndërsa në vitin e tretë sigurohen njohuritë e detajuara profesionale, nëpërmjet lëndëve karakterizuese si edhe lëndëve ndërdisiplinore/integruese.</p> <p>Planet mësimore të tre viteve të fundit si edhe dokumenta plotësuese për vitin akademik 2021-2022, tashmë të analizuar dhe të referuara, sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevojiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60ECTS) është llogaritur 1,500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% (860 orë) përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p><i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim</i></p>

	<p><i>Logjistik.</i> <i>Tabelat Përmbledhëse (Tabela 12.3, 12.4, 12.5 dhe 12.6).</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative në lidhje me programin që vlerësohet, “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve Diplomë Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”, në sajë të së cilës ata mund të ushtrojnë profesionin si ndërlidhës ndërmjet stafit të teknologjisë së informacionit dhe administrim biznesit në institucionet publike, private dhe jo qeveritare.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin përkatës.</p> <p>Plani mësimor përveç argumentave të mbështetura në analizën e kritereve të standartit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Siç konstatohet, lëndët e profesionit kryesisht realizohen pas semestrit të tretë të studimeve, së bashku me detyrimet përfundimtare, Diplomën ose provimin e përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është në përputhje të plotë me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vlerësimi i praktikës në kohë dhe nëpërmjet krediteve, thekson natyrën praktike dhe efektive të njohurive të siguruar, duke rritur vlefshmërinë e diplomës së përfutur.</p> <p>GVJ konkludon se struktura e programit është plotësisht e përputhshme me programe të ngjashme ndërkombëtare, në shtesë të faktit që ky institucion është unik në vend.</p> <p><i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</i> <i>Tabelat Përmbledhëse.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Objektivat formuese të programit, të specifikuar tek Statuti, Rregullorja e institucionit, Rregullorja e Fakultetit dhe Plani Strategjik i Zhvillimit të Njesisë, 2017-2022, janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor.</p> <p>Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. GVJ gjykon që arritja e objektivave formuese në çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese si sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik.</p>

	<p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKËS.</i> <i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Universitetit Epoka.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperiencën e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e shumicës së pedagogëve, këmbimi i eksperiencës me pedagogët e huaj, pedagogë efektivë të departamentit dhe të programit që vlerësohet, si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme.</p> <p>Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Përditësimi përfshin literature bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi si edhe metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies. Fakti që mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze dhe që pranimit në universitet kushtëzohet nga njohja cilësore e gjuhës angleze, lehtëson përdorimin e literaturës së përditësuar. Njësitë ka akses tek literature bashkëkohore, burimet e të cilës janë plotësisht të disponueshme edhe nga studentët.</p> <p>Ndryshimet në literature miratohen çdo vit akademik. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës.</p> <p>Megjithatë GVJ konstaton se, programi që vlerësohet nuk ka ndryshuar dhe se nuk është zhvilluar ndonjë vlerësim tregu përpara hapjes të programit.</p> <p>GVB ka dërguar evidenca shtesë (Shtojca 20) për argumentimin e përputhshmërisë së programit me kërkesat e tregut, të cilat janë marrë në konsideratë nga GVJ për vlerësimin e standardit.</p> <p><i>Syllabuset, 2018-2019; 2019-2020; 2021-2022.</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit.</i> <i>Vizita në institucion.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 20 Survey on curricula changes.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive të larmishme mbi Menaxhimin në përgjithësi, Marketingun në përgjithësi dhe në veçanti në harmonizimin e tij me Menaxhimin Logjistik.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ gjykon që komenti i paraqitur tek standardi II.1, kriteri 2, në lidhje me peshën e lëndëve të marketingut dhe të menaxhimit logjistik në raport me totalin e lëndëve, duhet ri-përmendur edhe këtu.</p> <p><i>Syllabuset, 2018-2019; 2019-2020; 2021-2022.</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit.</i></p>

<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p><i>Vizita në institucion.</i></p> <p>Nisur nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Objektivat formuese të programit; ▪ Harmonizimi i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me zgjedhje dhe plotësuese; ▪ Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike; ▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së literaturës; ▪ Përmirësimi i metodave të mësimdhënies; ▪ Kriteret e pranimit dhe transferimit, <p>GVJ mbështetet përfundimin se program i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës. Opinionet e studentëve të shprehura gjatë vizitës në institucion janë treguesi më i qartë për plotësimin e kriterit 8 të vlerësimit.</p> <p><i>Vizita në institucion.</i> <i>Dosja e vlerësimit të programit.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Njësia bazë i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimit, gjë e cila konstatohet nga dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni, mbi kriteret dhe formatin e syllabuseve, si edhe materialet didaktike të nevojshme që duhet të përfshihen në mënyrë të detyrueshme në syllabus.</p> <p>Njësia bashkëpunon me partnerë të fushës akademike dhe jo akademike, nëpërmjet të cilëve synon të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies si edhe të lehtësojë kontaktet e studentëve me tregun e punës. Njësia mbështet veprimtarinë e saj në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së programeve tek dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni. Megjithatë, GVJ konstatoi se pas akreditimit të parë, njësia nuk ka kërkuar asnjë ndryshim programi.</p> <p>GVJ konstatoi se njësia, përgjatë zbatimit të strategjisë së zhvillimit, ka analizuar efektivitetin e bashkëpunimeve me partnerët akademikë dhe jo akademikë dhe i ka rezultuar veprimtari tejet frytdhënëse. Analiza është paraqitur tek Shtojca 16.</p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit për avancimin e programeve të studimit në Administrim Biznesi. 2020</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="580 1935 778 2002">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="778 1935 976 2002">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="976 1935 1174 2002">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

standardit		X	
------------	--	---	--

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit, i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë, ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKËS.</i> <i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Universitetit Epoka.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit.</i> <i>Aneksi 73. CV-të e stafit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik që angazhohet në realizimin e programit “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.</p> <p>Programi “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” realizohet nga 10 pedagogë efektivë të departamentit, nga të cilët 3 janë të huaj, si edhe 2 pedagogë me kohë të pjesshme. Stafi efektiv përbëhet nga 3 (30%) Prof.Dr dhe Prof. Asoc.Dr, 4 (40%) Dr dhe 3(30%) MSc.</p> <p>Njësia bazë merr të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shkencor të stafit, e cila realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia. • Pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. • Pjesëmarrjes në projekte • Shkëmbimeve akademike nëpërmjet projektit Erasmus. <p>Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit nëpërmjet raporteve që plotësohen nga secili përfitues, pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.</p> <p>Diskutimet me stafin gjatë vizitës në institucion përforëcuan opinionin se mobiliteti i stafit është një mënyrë shumë e mirë për</p>

	<p>rritje dhe zhvillim.</p> <p>Duke marrë shkas nga situata tepër e vështirë dhe e veçantë e këtij viti e shkaktuar nga pandemia, gjatë vizitës u diskutua nëse stafi akademik u ndihmua me trajnime për të mundësuar njohjen dhe përvetësimin e teknologjive të reja, për realizimin e mësimit online. Rezulton se pandemia mundësoi njohjen me teknologji të reja, të cilat nëpërmjet ndihmës së zyrës së IT krijuan kushtet që mësime online të funksionojë mirë. Infrastruktura e zhvilluar dhe e përshtatshme e universitetit, nga më të mirat në vend, ka qenë një faktor përcaktues për mbarëvajtjen e mësimit online si edhe realizimin e aktiviteteve të tjera zhvilluese dhe kualifikuese.</p> <p>Stafi mbështetet financiarisht nga institucioni përgjatë rrugëtimit të rritjes profesionale dhe të aplikimit të praktikave bashkëkohore të mësimit.</p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit për avancimin e programeve të studimit në Administrim Biznesi 2020</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.</p> <p>Programi “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” për vitin akademik 2021-2022 realizohet nga 18 pedagogë PAE dhe 4 PAK, nga të cilët 8 pedagogë PAE dhe 2 pedagogë PAK, janë staf i Departamentit të Administrim Biznesit, nga i cili buron programi që vlerësohet.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>Tabelat përmbledhëse (Tabela 12.6)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë, në përputhje me planin e saj të kërkimit shkencor si edhe në bashkëpunim me institucione me të cilët ka një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, përcakton fushat e studimit, për të cilat informohen studentët, që paraqisin kërkesat e tyre në lidhje me tematikën që do të studiojnë përgjatë përgatitjes së diplomës përfundimtare (vetëm studentët me notë mesatare mbi 8, ekuivalent i koeficientit 3, sipas sistemit të brendshëm të vlerësimit).</p> <p>Departamenti finalizon ndarjen e temave në përputhje me përkatësinë shkencore të stafit akademik. Çdo studenti i sigurohet një udhëheqës, me të cilin bashkëpunon deri në përfundim të realizimit të punimit.</p>

	<p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKËS.</i> <i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Universitetit Epoka.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Udhëzues mbi zhvillimin e studimeve dhe provimeve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë dhe institucioni përpiqen që të sigurojnë angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të tjera, pjesë e programit mësimor, duke mobilizuar studentët e vitit të fundit. Deri në vitin 2021, njësia ka aktivizuar numër të konsiderueshëm të personelit ndihmës akademik, ndërsa në vitin akademik 2021-2022, në listën e stafit nuk figuron personel ndihmës akademik.</p> <p>Pjesë e stafit të Njesisë është 1 koordinatorë për të gjithë departamentin, detyrat e së cilës janë të përcaktuara në rregulloren e fakultetit.</p> <p>Njësia është e paisur me mjete pune të nevojshme për realizimin e procesit akademik (fotokopje, kompjutera etj).</p> <p>GVJ gjykon që personeli ndihmës mësimor shkencor është i pamjaftueshëm për të garantuar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKËS</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Universitetit Epoka.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me KPSC (Komisioni i përhershëm i Sigurimit të Cilësisë) kujdeset për monitorimin e

inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.

procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë periudhës së pandemisë Covid 19 Universiteti EPOKA ka asistuar personelin të krijojë metoda më novatore dhe të standartizuara të mësimdhënies përmes sistemit të Menaxhimit të Mësimit (LMS) bazuar në Moodle dhe Google Classroom e Google Apps për shërbimet e Edukimit.

Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga KPSC në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse. Procesi realizohet duke përdorur disa procedura dhe instrumenta si:

- Monitorimi i provimeve në sezonin e provimeve përfundimtare, ku kontrollohet mënyra e vlerësimit dhe procedura e rivlerësimit të studentëve. Rezultatet pasqyrohen në raportet përkatëse;
- Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët përmes anketimit semestral të tyre. Pas zbardhjes së tyre hartohet raporti i cili u vendoset në dispozicion departamentit dhe pedagogëve përkatës;
- Dokumentim i performances akademike nga stafi akademik, i cili në mënyrë periodike pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve;

Universiteti EPOKA bën vlerësime periodike të mësimdhënies nga studentët përmes anketimeve. Anketimi hartohet nga KPSC dhe synon mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimit dhe çdo dukuri tjetër të lidhur me të. Rezultatet e anketimit janë pjesë e analizës vjetore të njësisë.

Sa më sipër GVJ konstaton se janë përcaktuar në statutin e Universitetit EPOKA dhe në rregulloren e brendshme të Fakultetit të ekonomisë, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe mënyrat e kontrollit të dijeve. Gjithashtu udhëzimet dokumentohen dhe përmes rregullores dhe udhëzuesit të KPSC.

Anksi 2. Statuti i EPOKA

Aneksi 3. Strategjia dhe Plani i Veprimit të Universitetit EPOKA 2018-2022

Aneksi 6. Rregullorja e FEAS

Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPPK-së

Aneksi 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë."

	<p><i>Aneksi 28 Trajnime për Stafin Akademik</i> <i>Aneksi 61. Politika e Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, Universiteti EPOKA ka organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësia ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor, Njësia e Standardeve dhe Cilësisë, kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit;</p> <p>Veprimtaria e KPSC përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances; • Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; • Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; • Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion. <p>Kjo njësi ndjek me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e saj miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.</p> <p>Në programin Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik format kryesore të mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione • Seminare • Projekte/Detyra, (pjesë e vlerësimit të lëndës) • Praktikë profesionale <p>Pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimin, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimin të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për tu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.</p> <p><i>Anksi 2. Statuti i EPOKA.</i> <i>Aneksi 3. Strategjia dhe Plani i Veprimit të Universitetit EPOKA</i></p>

	<p>2018-2022.</p> <p><i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i></p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p> <p><i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPPK-së.</i></p> <p><i>Aneksi 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët marrin pjesë aktive në vlerësimin e metodave të mësimdhënies sipas procedurës të paraqitur në Regulloren e brendshme të FEAS. Ky proces zhvillohet dy here në vit, në përfundim të çdo semestri, përmes një anketimi të administruar në sistemin EIS i cili i kërkon studentit vlerësimin e lektorit dhe strukturën e secilës lëndë. Rezultatet përpunohen nga KPSC dhe janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me performancën e stafit.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p> <p><i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPPK-së.</i></p> <p><i>Aneksi 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga KPSC në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse.</p> <p>GVJ u njoh me procedurën gjatë vizitës në institucion, ku veç të tjerash u njohëm nga KPSC dhe Përgjegjësi i Departamentit se si mekanizëm monitorimi shërben dhe dokumentimi periodik i performancës akademike të pedagogëve, i cili pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve. Kjo e fundit raportohet në raportin vjetor të Departamentit të Administrim Biznesit.</p> <p>GVJ konstaton se vlerësimi bëhet publik përmes faqes së universitetit në Raportin e Vetëvlerësimit.</p> <p>https://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html?lang=EN&dpid=2&t=internal-evaluation-reports&catid=1479&menuid=1480</p> <ul style="list-style-type: none"> • Self Evaluation Report for Institutional Review, April 5, 2017 • Self Evaluation Report for Institutional Review, April 6, 2021 <p><i>Anksi 2. Statuti i EPOKA.</i></p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p>

	<p><i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e KPPK-së.</i></p> <p><i>Aneksi 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Aneksi 30. Menuja e Universitetit EPOKA Raporte Vjetore</i></p> <p><i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSC) u vë në dispozicion vlerësimet e anketës drejtuesve të institucionit dhe drejtuesve të njësisë. Nga takimet e zhvilluar me (KPSC) dhe përgjegjësin e departamentit u pohua se rezultatet e gjeneruara nga vlerësimet bëhen publike në mbledhjet e departamentit dhe promovohen shembujt e praktikave më të mira, ndërsa merren masa për përmirësimin e mëtejshëm. Institucioni është angazhuar në rritjen e angazhimit kërkimor të stafit, përmes rimbursimit të pjesëmarrjes në konferenca dhe publikimeve në revista shkencore; si dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes ofrimit të mundësive të mobilitetit për mësimdhënie përmes programeve Erasmus + në Universitete partnere.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p> <p><i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e KPPK-së.</i></p> <p><i>Aneksi 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, detyrat dhe projektet e kursit, rastet e studimit, testimet e programuara, praktika profesionale dhe në fund finalizohen me punimin e diplomës, siç dokumentohen në programet lëndore: 2021-2022; 2020-2021; 2019-2020</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin e administrim biznesit) dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si <i>Plani Strategjik i Departamentit 2017-2022</i>, dhe në <i>Raportet vjetore të departamentit</i> por u pohua dhe në takimet e GVJ me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit. GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në</p>

	<p>dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimi, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimi të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gadishmërinë e pedagogëve. Mjedisi dhe pajisjet audio-vizuale të Universitetit EPOKA janë në avantazh të mësimdhënies bashkëkohore.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e KPPK-së</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve</p> <p>Programi Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik përfshin format e mësimi teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik. Për shkak të karakterit praktik të moduleve, përdorimi i rasteve reale të bizneseve për studim e bën më tërheqëse dhe aplikativ programin për studentët. Siç u pohua prej tyre, pedagogët janë të gatshëm të përgjigjen dhe asistojnë studentët për çdo paqartësi.</p> <p>Siç evidentohet dhe në raportet vjetore të Departamentit të Administrimit Biznesit, organizohen workshope, takime e trainime me përfaqësues për të mbështetur procesin mësimor në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>Aneksi 31. Raporti Vjetor viti akademik 2017-2018 departamenti BUS</i> <i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Përkatësisht nga takimi me studentët u pohua se studentët kanë patur mundësinë të diskutonin me menaxherë të bizneseve të ftuar si metodë e re pedagogjike, në përputhje me objektivat formuese të lëndëve dhe rritjen e kopetencave sipas kërkesave të punëdhënësve.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, Universiteti EPOKA ka në dispozicion infrastrukturën dhe laboratorë e salla multimediale ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p>Departamenti angazhohet në organizimin e aktiviteteve me përfaqësuesit e industrisë në mbështetje të përmirësimit të mësimdhënies sic paraqiten në raportet vjetore të departamentit 2017-2018 & 2018-2019, 2019-2020.</p> <p><i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>Aneksi 31. Raporti Vjetor viti akademik 2017-2018 departamenti BUS</i> <i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i përfshirë në programin Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik nuk përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Gjysma e stafit akademik nuk mban grada shkencore dhe ka titullin Msc. në proces doktorature. Stafi akademik është i kufizuar në numër dhe gjithashtu angazhohet në këshillim për studentët dhe ndihmon e asiston ne detyra administrative.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit i personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar.</p> <p><i>GVJ rekomandon fort të rritet numri i PAE me grada dhe tituj si kusht për mësimdhënie në programin e studimit dhe zhvillimin e kopetencave kërkimore-shkencore të tij.</i></p> <p><i>Aneksi 73. CV-të e stafit</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se departamenti i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Departamenti mbledhet periodikisht për të evidentuar arritjet dhe problematika që duhen përmirësuar. Në funksion të përmirësimit të metodave të mësimdhënies përdoren</p>

	<p>dhe anketimet nga KPSC dhe vetë Departamenti.</p> <p>Institucioni ka realizuar zhvillimin e aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione të hapura, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. Metodatat e reja janë diskutuar nga stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit, i cili periodikisht rishikon metodatat e mësimdhënies. Gjithashtu bashkëpunimet me universitetet partnere ndihmojnë në trainimin e shkëmbinim e stafit për mësimdhënie.</p> <p><i>GVJ inkurajon më tepër mbështetje me veprimtari praktike të procesit mësimor të programit me qëllim forcimin e mjeshtrive teknike e aplikative në përafrim të kërkesave të tregut të punës.</i></p> <p><i>Aneksi 12. Kurrikula e programit</i> <i>Aneksi 31. Raporti Vjetor viti akademik 2017-2018 departamenti BUS</i> <i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>GVJ realizoi takim me stafin akademik dhe studentët dhe evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase. Materialet didaktike të përdorura përbëhen dhe nga materiale audivizuale të cilat krijojnë situata diskutimesh interaktive dhe nxisin punën në grupe të studentëve.</p> <p><i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodatat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në : ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunimin në zgjidhjen e problemave në seminare. Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projektet e hartimit të diplomës dhe lehtësohet përmes sistemit të komunikimit me studentët.</p> <p><i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 31. Raporti Vjetor viti akademik 2017-2018 departamenti</i></p>

	<i>BUS</i> <i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>RVB përmban të dhëna të hollësishme mbi infrastrukturën në funksion të mëimit dhe shërbimet e tjera në funksion të komunitetit. Të dhënat e raportuara përputhen me të dhënat e verifikuara gjatë vizitës së GVJ në institucion.</p> <p>Nga vëzhgimi i GVJ dhe evidenca nr 35 vlerësohen hapësirat e Universitetit dhe kapacitetet e bollshme me zyra, mjedise shërbimi, hapësira recreative dhe mjedise për aktivitete të ndryshme.</p> <p>Klasat janë të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që mundësojnë zhvillimin interaktiv të procesit mësimor.</p> <p><i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i></p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit konstatoam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për zhvillim e mësimdhënies cilësore. Në këto mjedise vëzhguam salla leksione e seminare, laboratorë, salla mbledhjesh, zyra e studio të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi. Ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas VKM nr 418, date 10.05.2017, është 2.5 m2 për student. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me mjetet didaktike të avancuara për zhvillimin e praktikës mësimore. Stafi i IT-së ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mëimit.</p> <p><i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i></p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për	<p>Gjatë vizitës GVJ u njoh me infrastrukturën dhe sistemet informatike në funksion të procesit mësimor.</p>

<p>realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Studentët, stafi akademik dhe ndihmës akademik mbështeten tek Sistemi i informacionit të edukimit (EIS) bazuar në Udhëzuesin e EIS, Shtojca 18.1, 18.2. Personeli dhe studentët njësoj mund të hyjnë në EIS duke përdorur kredencialet e llogarisë së emailit të Universitetit “EPOKA dhe sigurojnë informacionin e nevojshëm në lidhje me universitetin, programet që universiteti ofron, programet e shkëmbimit të studentëve, njohjen e diplomave, rregulloret e universitetit, etj.</p> <p>Në përbërje të këtij sistemi janë të integruara edhe disa platforma të cilat shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimnxënies dhe sigurimin e komunikimit midis personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve.</p> <p>Moodle - është një shërbim on-line, i cili iu ofron studentëve mundësinë të aksesojnë leksionet në mënyrë interaktive kudo që janë. Profesorët e lëndëve i azhurnojnë në këtë server të gjitha leksionet dhe materialet që kanë lidhje me lëndën dhe studentët pasi pajisen me emër përdoruesi dhe fjalë kalimi nga profesori kanë mundësi ti aksesojnë ato.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid 19 Sistemi LMS Moodle dhe Google Classroom u përdor me sukses nga pedagogët dhe studentët për zhvillimin e mësimin online, testimeve dhe provimeve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ zhvilloi takim me njësinë e IT dhe stafin programues të Universitetit Epoka ku vlerësoi investimin teknologjik të institucionit.</p> <p><i>Aneksi 18.1 Udhëzues EIS – Pedagogët</i> <i>Aneksi 18.2. Udhëzues EIS – Studentët</i> <i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura në modulet e këtij program studimi ofrohet në gjuhën angleze. Baza mësimore që u ofrohet studentëve përfshin tekste mësimore, cikle leksione, leksione në ppt, materiale plotësuese. Biblioteka ka sipërfaqe 400 metra², me kapacitet 100-vendësh dhe mbi 25000 tituj. Biblioteka ka revista periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra ose revista shkencore që janë të nevojshme për projektet kërkimore dhe përgatitjen e tezave. Universiteti “EPOKA” ka anëtarësim të plotë në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët dixhitale më shumë se 2,000 revista akademike.</p> <p>Nga vizita e GVJ në bibliotekë rezultoi se një pjesë e titujve dhe teksteve mësimore ishin të mbi 10 viteve të shkuara.</p> <p><i>GVJ sugjeron të pasurohet biblioteka në titujt bashkëkohor të literaturës të huaj e vendase për këtë program studimi.</i></p>

	<p><i>Syllabuset 2021-2022</i> <i>Syllabuset 2019-2020</i> <i>Syllabuset 2018-2019</i> <i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Biblioteka e Universitetit EPOKA funksionon si pjesë përbërëse e institucionit. Shërbimi bibliotekar kryhet prej punonjësve të caktuar posaçërisht nga institucioni dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 400 metra katror metra², me kapacitet 100-vendësh dhe mbi 25000 libra në gjuhë të ndryshme: shqip, anglisht, turqisht dhe gjuhë të tjera. Salla e leximit është e projektuar me qëllim që studentët të kenë mundësi për të studiuar dhe për të bërë kërkime.</p> <p><i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online në të cilat Universiteti EPOKA është abonuar, si JSTOR, një bibliotekë e përbashkët dixhitale e krijuar që përfshin më shumë se 2,000 revista akademike dhe shkencore si dhe baza e të dhënave elektronike ERA të menaxhuara nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe burime të tjera në internet si EBSCO Academic Search Complete, Emerald Management e-Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, OECD eLibrary, Oxford English Dictionary Online, Oxford Reference Online, ProQuest Central, Taylor & Francis Library, Web of Knowledge etj.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen (përmes një llogarie unike dhe fjalëkalimi), të përdorin dhe shkarkojnë revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, Universiteti EPOKA ka përqasur më së miri standardet evropiane të infrastrukturës në mësimdhënie. Pajisjet për zhvillimin e orës mësimore janë të teknologjisë bashkëkohore dhe në funksion të interaktivitetit në mësimdhënie; Institucioni ka tre laboratorë mësimorë informatike të pajisur me programe profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit me rrjete interneti wifi; Paketa Office 365 dhe Dream Spark.</p> <p>Studentët shfrytëzojnë më së miri këto teknologji në zgjidhjen e rasteve studimore, zhvillimin e detyrave të kursit dhe aplikimet teorike.</p>

	<p><i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i> <i>Aneksi 68. Sherbime Zyre ICTC</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka në përdorim disa sisteme për mësimdhënie, administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të materialeve nga pedagogët, sekretaria mësimore dhe koordinatorët për studentët.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion, RVB dhe evidencat e infrastrukturës (Aneksi 35) dallohen:</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Mësimit (LMS)- Një shërbim i bazuar në Moodle ofrohet për studentët dhe lektorët me qëllim të kenë akses në të, koordinojnë dhe organizojnë materialet e lëndët online.</p> <p>Sistemi i informacionit të edukimit (EIS) - një sistem interaktiv ku studentët mund të kontrollojnë pjesëmarrjen, datat e provimit, notat e përkohshme dhe notat përfundimtare. Gjithashtu, ata mund të aksesojnë kurrikulën e programit, listën e notavë, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet. Ndërsa lektorët mund të përditësojnë Silabusin, të shohin pjesëmarrjen e studentëve në mësim, të vendosin dhe të finalizojnë notat.</p> <p>Sistemi i Automatizimit të Bibliotekave (Koha)- një sistem i integruar i bibliotekave me burim të hapur. Përdoruesit mund t'i kontrollojnë librat online dhe t'i rezervojnë ato përmes internetit. Në kushtet e pandemisë Covid 19 dhe zhvillimit të mësimdhënies online Universiteti EPOKA adoptoi platformën Google Classroom të cilën nga takimet me stafin dhe studentët rezultoi se përdorej me lehtësi dhe garantonte menaxhimin e procesit mësimor, për shkëmbimin e njohurive dhe materialeve të nevojshme për programin e studimit.</p> <p>GVJ konstatoi se Universiteti Epoka ka një sistem informatik bashkëkohor në aspektin e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Aneksi 35. Tabela Përmbledhëse për Infrastrukturën</i> <i>Aneksi 68. Sherbime Zyre ICTC</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se Universitetit EPOKA ka infrastrukture të konsoliduar për realizimin e programit mësimor.</p> <p>Sistemi EIS përdoret nga studentët, stafi akademik dhe ndihmës akademik duke u mbështetur tek Manuali i Sistemit Elektronik. Në përbërëse të këtij sistemi është integruar edhe Sistemi i komunikimit të brendshëm Moodle i cili është i aksesueshëm nga pedagogë dhe studentë dhe ka për qëllim të informojë dhe lehtësojë lidhjen mes tyre. Nëpërmjet tij ofrohen informacione, leksione, materiale mbështetëse etj. Çdo pedagog dhe student përdor kredencialet e programit dixhital EIS për të</p>



	<p>patur akses në aplikacionin Moodle.</p> <p><i>Aneksi 18.1 Udhëzues EIS – Pedagogët</i> <i>Aneksi 18.2. Udhëzues EIS – Studentët</i> <i>Aneksi 68. Sherbime Zyre ICTC</i></p>		
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit, departamenti dhe pedagogu udhëheqës. Punimet mbulojnë tema kryesisht në fushat e studimit të marketing, logjistik dhe menaxhim të cilat specifikohen pas konsultimeve të vazhdueshme të studentëve me mbikqyrësit.</p> <p>Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet për konsultime dhe realizimin e tij. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike me studentët që udhëheq, për të garantuar shkrimin e punimit në përputhje me standartet e punimit shkencor. Udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e paraqitur nga studenti përpara mbrojtjes.</p> <p>GVJ konstaton se procesi i realizimit të temave të diplomës paraqitet në Udhëzuesin e Diplomës.</p> <p><i>Aneksi 50. Udhëzues i punimit të diplomës</i> <i>Aneksi 52. Formulari i Vlerësimit të Tezës së Diplomimit</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, Universiteti EPOKA ka organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standartet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit; • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarisë që ushtrohet në Universitetin EPOKA, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të

	<p>cilësisë;</p> <p>Veprimtaria e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances; • Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; • Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; • Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion. <p>Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve përbëjnë Njësine e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme ndjekin me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e tyre miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.</p> <p><i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e KPPK-së.</i></p> <p><i>Aneksi 8.2 Direktiva "Për vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Cilësia e procesit të mësimdhënies është në fokus të Departamentit të Administrimit Biznesit dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të performancës akademike këto dy njësi bashkëpunojnë ngushtësisht me KPSC-në për garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtijshëm profesional. Gjithashtu për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, ndiqen si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të fuar të cilët janë personalitete në fushën e tyre, por dhe të huaj, pjesë e të cilëve janë dhe nga programi ERASMUS+.</p> <p>Referuar shtojcës 28 - Aktivitete dhe Trajnime për personelin akademik, një nga trajnimet për personelin e institucionit u organizua nga përfaqësuesit e shtëpisë botuese Pearson në lidhje me përdorimin e teknologjisë në përgatitjen e materialeve mësimore. Lektorët u inkurajuan për të aplikuar zhvillimet më të fundit teknologjike me përdorimin e programeve të simulimit.</p>

	<p>Nga ana tjetër komiteti shkencor i departamentit inkurajon për të zhvilluar planprogramet e lëndëve në përgjigje të tendencave të tregut.</p> <p>Të gjitha këto aktivitete i shërbejnë rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 11.2 Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit</i> <i>Aneksi 28 Trajnime për Stafin Akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Pedagogët në programin e studimit Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime, punime individuale dhe në grupe. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë konceptet dhe stimulon aplikimin e tyre në praktikë. Kjo e fundit u pohua dhe nga takimi që GVJ zhvilloi me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se infrastruktura ndihmon për integrimin e metodave inovative në mësimdhënie. Duke ju referuar platformave Moodle, EIS, Google Meet, Google Classroom, Office 365 for Education, kanë ndihmuar rritjen e cilësisë të mësimdhënies, komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni, ndërmjet personelit akademik dhe studentëve veçanërisht gjatë pandemisë.</p> <p><i>Aneksi 11.2 Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit</i> <i>Aneksi 28 Trajnime për Stafin Akademik</i> <i>Aneksi 68. Shërbimet e Zyrës ICTC</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në planin strategjik të Universitetit EPOKA, prioritet është kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si faktor kyç në promovimin e institucionit dhe programeve të studimit. Universitetit EPOKA u ofron personelit akademik mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme përmes pjesëmarrjes në konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimet në revistat shkencore, pjesëmarrjen në projekte të ndryshme, sipas profileve të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe dosjeve personale të pedagogëve vihet re se personeli i angazhuar në këtë program është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në fushat që përfshihen në programin e studimit. Veprimtaria kërkimore-shkencore e stafit analizohet në raportet vjetore të veprimtarisë së departamentit.</p> <p><i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Strategjia i Zhvillimit të Departamentit, 2017-2022.</i> <i>Aneksi 28. Trajnime për Stafin Akademik</i></p>


	<i>Aneksi 73. CV-të e stafit</i>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Departamenti i Administrim Biznesit realizon leksione me pjesëmarrje pedagogë dhe specialistë të fushës së marketingut, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga personeli akademik. Në kuadër të rritjes së performancës mësimore dhe zhvillimit të metodave inovative kanë ndihmuar dhe shkëmbimet e trainimit Erasmus+.</p> <p>Nga takimet në institucion dhe evidenca 28, GVJ vlerëson se njësia bazë angazhohet në ofrimin e trainimeve dhe workshopeve nga trajnerë ndërkombëtarë për personelin akademik si mjet motivues për zhvillimin e metodave e praktikave të reja të mësimdhënies, dixhitalizimin dhe përmirësimin e aftësive kërkimore.</p>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p><i>Aneksi 28. Trajnime për Stafin Akademik</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ofron trajnime ndërkombëtare në kuadër të programit Erasmus+ për stafin akademik dhe personelin ndihmes akademik për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja nëpërmjet praktikës së trainimeve të hapura.</p> <p>GVJ në takimet me drejtuesin e Departamentit, stafin akademik, dhe KPSC, u njoh me faktin që konceptimi i procesit mësimor është bërë duke synuar vënien e studentit në qendër. Kjo ka sjelle ndryshim nga metoda tradicionale, duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime dhe pyetje studentit. Zhvillimi i orëve interaktive, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit, nxitja e debateve, mendimit kritik, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet e punimeve janë disa prej mjeteve kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor.</p> <p>Metodat e reja të mësimdhënies, nëpërmjet seminareve të dedikuara, leksioneve të hapura workshope etj, me qëllim përmirësimin e këtij procesi në vijimësi.</p> <p>Përfshirja e studenteve dhe vjelja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies është periodike për të gjitha aspektet akademike dhe administrative të Universitetit EPOKA.</p>
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p><i>Aneksi 31. Raporti Vjetor viti akademik 2017-2018 departamenti BUS</i></p> <p><i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar rregulloren e programit të studimit Bachelor (Annex 7) kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet dy rubrikave: vlerësimi i vazhduar (përfshin aktivizimin në seminare, testimin e ndërmjetëm, detyrat e projektet e kursit) dhe vlerësimi në provim përfundimtar. Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të cdo semestri.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Syllabusi ngarkohet në sistemin EIS dhe Moodle nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët. Gjithashtu, në webfaqen e Universitetit Epoka gjenden të publikuara rregulloret e institucionit dhe programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar Menaxhimit Logjistik 2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Syllabuset e çdo lëndë përmbajnë kontrollet që do të kryhen gjatë zhvillimit të saj. Vlerësimi i kontrolleve bëhet me pikë që i bashkohen vlerësimit përfundimtar. Në vlerësimin përfundimtar kontribuojnë edhe frekuentimi, detyrat e kursit, aktivizimi gjatë zhvillimit të ushtrimeve dhe mësimëve praktike. Pedagogu informon studentet për rezultatet e çdo kontrolli. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.</p> <p>Studentët e programit të studimit mund të informohen edhe në distance përmes sistemit EIS dhe Moodle në lidhje me lëndët, përmbajtjen e tyre dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Syllabuset 2018-2019</i> <i>Syllabuset 2019-2020</i> <i>Syllabuset 2021-2022</i></p>



<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Universiteti EPOKA i kushton shumë rëndësi transparencës së vlerësimit. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik EIS lejon secilin student të njihet vetëm me vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit.</p> <p>Bazuar në Silabuset e lëndëve, testimi e vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në forma të ndryshme si: pjesmarrja aktive; plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit); testimet gjatë vitit; provimi përfundimtar.</p> <p>GVJ konstaton se forma të ndryshme vlerësimi nxisin angazhimin e studentit dhe respektojnë lirinë akademike të stafit. Në çdo silabus format e vlerësimit përputhen me përmbajtjen dhe natyrën e lëndës.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Syllabuset 2018-2019</i> <i>Syllabuset 2019-2020</i> <i>Syllabuset 2021-2022</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi gjatë vitit inkurajon angazhim dhe ndërveprim të studentit dhe e përgatit atë për sezonin e provimeve. Siç u përmend dhe në standartin III.5 raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Në silabuset e lëndëve përdoren një larmi strategjish dhe skema vlerësimi, duke përfshirë projekte, punime, prezantime, diskutime në klasë, studime të rasteve etj.</p> <p>Vlerësimi gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike përmes sistemit EIS. Gjithashtu rezultatet e studentit dokumentohen në dokumenta si regjistri dhe pasqyra e vlerësimit dhe janë të depozituara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Syllabuset 2018-2019</i> <i>Syllabuset 2019-2020</i> <i>Syllabuset 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të</p>	<p>Universiteti Epoka i kushton rëndësi transparencës dhe</p>

<p>testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>privatësisë së vlerësimit. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik EIS lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se Universiteti Epoka përdor format e vlerësimit elektronike çka redukton abuzimin dhe subjektivitetin e vlerësimit të studentëve. Sistemi EIS gjeneron një kod sekretimi për çdo student dhe siguron objektivitet në vlerësim.</p> <p>Gjithashtu Universiteti Epoka përdor sistemin Turnitin, shërbim plagjaturë në internet, për të kontrolluar punimet e studentëve dhe tezat e diplomimit për ngjashmërinë dhe për referencë.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 37 Udhëzues "Për provimet"</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar rregullores së ciklit të parë të studimit dhe rregullores së provimeve, komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Në rastin e mbrojtjes së praktikës dhe diplomës realizohet me komision me jo më pak se tre anëtarë, përfshi udhëheqësin. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani.</p> <p>Vlerësimi i diplomës është kusht për përmbushjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.</p> <p>Komisionet përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamenti në përputhje me Rregulloren në fuqi.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 37 Udhëzues "Për provimet"</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit dhe vizita në institucion u vu re se format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit në sistemin EIS. Vlerësimi dhe kontrolli i dijeve përcaktohet nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës për hartimin e tezës së provimit dhe është plotësisht përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së vlerësimit.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të Universitetit Epoka, u njoh me dokumentacionin dhe procedurën e vlerësimit të dijeve. Insitucioni ka vendosur kamera sigurie për të shmangur sjellje jo etike në bazë të rregullores së provimeve dhe specifikuar në annex 41.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 37 Udhëzues "Për provimet"</i> <i>Aneksi 41 Udhëzues për Funkcionimin e Sistemit CCTV</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i</p>	<p>Studentët e programit Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe</p>

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Menaxhim Logjistik zhvillojnë projekte, detyra kursi dhe raste studimore në çdo lëndë. Nga takimi me studentët, GVJ u informua se pedagogu i lëndës i orienton studentët mbi të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve. Në vazhdimësi ata udhëzohen mbi zhvillimin e detyrave të kursit dhe rasteve studimore. Gjatë zhvillimit të tyre dhe në mbrojtjen e tyre studentët marrin këshilla dhe vlerësim nga pedagogu lidhur me aspektet pozitive dhe negative dhe çfarë duhet të përmirësojnë. Numri i vogël i studentëve në këtë program studimi lehtëson ndjekjen individuale të tyre dhe ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies.</p> <p>Gjithashtu, vlerësimi i dijeve në provim shoqërohet me komente sa herë pedagogu e gjykon të nevojshme. Pas provimit, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Rezultatet e provimit, përpilohen në sistemin EIS dhe studentëve ju lihet 48 orë në dispozicion për të paraqitur ankesat e tyre. Pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve në sekretarinë mësimore siç udhëzon rregullorja.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullat e zhvillimit të kontrolleve të dijes përcaktohen dhe në rregulloren e FEAS dhe Kodin e Etikës ku janë të specifikuar qartë dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës.</p> <p>Gjatë zhvillimit të provimit ndalohet hyrja e personave të jashtëm me përjashtim të pedagogëve të autorizuar për mbikqyrje. Studenti lejohet të paraqitet në provim vetëm pasi ka një mjet identifikimi si karta e studentit ose kartë identiteti. Gjatë provimit ndalohet celulari dhe personi që përdor mjete të tilla të palejueshme përjashtohet nga provimi.</p> <p>Lidhur me shmangien e plagjiaturës në detyra kursi apo tema diplome, institucioni ka vendosur një program specifik Turnitin, shërbim online për të siguruar që studentët të ndjekin praktikën e referencës dhe dokumentacionit transparent.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 39 Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit, vlerësimi i kontrollit të dijeve bëhet me pikë, të cilat më pas konvetohen në notë. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi amerikan dhe</p>

përkatëse.	<p>konvertohet në sistemin shqiptar të vlerësimit me nota nga 1-10, ku 10 është vlerësimi maksimal ndërsa nota kaluese është 5. Stafii akademik hedh në sistem rezultatet e vlerësimit të seminareve dhe detyrave të kursit, gjatë javës së 14-të të semestrit, duke ju përmbajtur afatit përkatës. Studentët njihen me rezultatet e akumuluar para datës së zhvillimit të provimit përfundimtar. Përmes sistemit online EIS, studenti informohet brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja e FEAS për rezultatet e provimit. Studentët njihen me notën përfundimtare pas zhvillimit të provimit sipas rregullores së institucionit dhe programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 39 Kodi i Etikës</i></p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren dhe procedurat e vlerësimit.</p>		
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka zhvilluar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Dekanati në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit ngre një komision ad hoc i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendimin. Vlerësimi i komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në një procesverbal të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet atij të mëparshmit si dhe pasqyrohet në sistemin elektronik EIS.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 38. Direktiva "Për Funkcionimin e Bordit të Provimeve"</i> <i>Aneksi 39. Kodi i Etikës</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 2019, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al



studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”, synon përgatitjen e studentëve në formimin e tyre si specialistë në fushën e marketingut dhe logjistikës; Dhënien e njohurive në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e ekonomisë, manaxhimit dhe marketingut me objektiv kryesor formimin e specialisteve të aftë për të punuar në marketing dhe realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë; Përdorimin e teknologjive të informacionit në funksion të marketingut.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit është respektuar ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese.</p> <p>Në disiplinat e formimit bazë studentët zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit në lidhje me ekonominë ,matematikën dhe sjelljen organizative të cilat i ndihmojnë në krijimin e kulturën e përgjithshme të fushës.</p> <p>Në disiplinat karakterizuese në fushën e mikro dhe makroekonomisë, statistika, kontabilitet, marketing studentët thellohen në proceset marketing- të segmentojnë tregun e synuar; pozicionojnë dhe diferencojnë ofertën në treg; të realizojnë një kërkim tregu, të menaxhojnë produktin, markën, menaxhojnë marrëdhëniet me konsumatorët.</p> <p>Në grupin e lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese studentët marrin njohuri nga një grup lëndësh me zgjedhje i lidhur me ekonominë ndërkombëtare, politikat monetare dhe e drejta e tregut.</p> <p>Në disiplinat plotësuese studentët aftësohen në përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike dhe përmirësojnë komunikimin në gjuhën e huaj e njohin përdorimin e terminologjisë në fushën e ekonomisë dhe marketingut.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës në formën e një projekti dhe provimit përfundimtar të kryerasipas Udhëzuesit të Diplomës dhe Provimit Përfundimtar (annex 49,50,51).</p> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit “Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”, garanton formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut dhe siguron njohuritë themelore në shkencën e marketingut të krahasueshme me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.</p>

	<p>Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit.</p> <p><i>GVJ inkurajon të shtohen lëndë të formimit karakterizues, lëndët e profilit marketing dhe logjistik në mënyrë që të thellohen dijet dhe kompetencat e profilit. Siç kemi sugjeruar të përfshihen lëndët si Marketing Dixhital, Menaxhim i forcës së shitjes, Menaxhim i kanaleve të shpërndarjes, Menaxhim global i logjistikës, Prokurimi Ndërkombëtar të detyrueshme në program.”</i></p> <p><i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar Menaxhimit Logjistik 2021</i></p> <p><i>Aneksi 49. Udhëzues për studentin për provimin përfundimtar të Departamentit të Administrimit të Biznesit</i></p> <p><i>Aneksi 50. Udhëzues mbi punimin e diplomes të programeve universitare</i></p> <p><i>Aneksi 51. Udhëzues mbi shkrimin e temës</i></p> <p><i>Syllabuset 2018-2019, 2019-2020, 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit “Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” paraqiten në programin dhe silabuset e çdo lëndë. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave e rezultateve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme lidhur me qëllimet e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë seanca konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p>Universiteti Epoka tregon vëmendje lidhur me interaktivitetin dhe bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik e i përhershëm që zhvillohet në të gjitha lëndët. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me orët e leksionit/seminarit apo të kërkojnë këshillime për çdo ide të tyre për inovacion apo zhvillim e zgjidhje të problemeve.</p> <p><i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar Menaxhimit Logjistik 2021</i></p>

	<i>Syllabuset 2018-2019, 2019-2020, 2021-2022</i>
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Në përcjelljen e informacionit mbi zhvillimet e reja të shkencës kanë shërbyer aktivitetet kombëtare e rajonale të zhvilluara nga FEAS përfshi dhe leksionet e hapura me të ftuar nga industria. Nga njësia përgjegjëse e programit të studimit planifikohen orët e hapura dhe diskutimet mbi zhvillimet aktuale të ekonomisë e biznesit. Gjithashtu, nga takimet në institucion, GVJ u njoh me aktivitetet e mbajtura si konferenca dhe workshope të bëra publike dhe në faqen web.</p> <p><i>GVJ inkurajon zhvillimin e bashkëpunimeve të mëtejshme të Universitetit EPOKA me partnerë kombëtare dhe ndërkombëtare për adoptimin e zhvillimeve të reja të shkencës dhe ndërkombëtarizimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p> <p><i>Aneksi 44. Faqja e internetit e Departamentit të Administrimit të Biznesit _ Universiteti Epoka</i></p>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	<p>Pas dhënies së informacionit teorik, studentët testohen ti aplikojnë ato në praktikë duke punuar në grupe pune puna e të cilëve materializohet në detyrë kursi, rast studimi, stimulim i zgjidhjes së një problem biznesi.</p> <p><i>GVJ sugjeron se zgjatja e praktikës profesionale do tu shërbente studentëve si faze reflektimi mbi kompetencat e fituara dhe qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve praktike.</i></p> <p><i>Aneksi 12. Kurrikula për Programin e Studimit Bachelor në Marketing Ndërkombëtar Menaxhimit Logjistik 2021</i></p> <p><i>Syllabuset 2018-2019, 2019-2020, 2021-2022</i></p>
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	<p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet dhe orienton studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Këto ide bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diplome.</p> <p>Universiteti Epoka e ka pjesë të strategjisë kërkimore përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore. Sipas RVB studentët kanë marrë pjesë dhe kanë prezantuar punimet e tyre në konferenca studentore si dhe kanë paraqitur punimet e tyre në konferencën studentore, kërkime nga pedagogët dhe mundësi të angazhohen në Marketingun e Universitetit, ku inkurajohen për zhvillimin e</p>
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	

	<p>ideve inovative në promovimin e Universitetit Epoka në kuadër dhe të bashkëpunimeve Erasmus+.</p> <p><i>GVJ thekson rëndësinë e mbështetjes financiare të studentëve për nxitjen e novacionit dhe kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Aneksi 53. Udhëzim "Për promovimin e publikimeve shkencore"</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në kuadër të strategjisë të ndërkombëtarizimit të Universitetit, është forcuar bashkëpunimi me Universitete partnere si pjesë e programit Erasmus+. Mobilitetet në instancat partnere kanë ndikuar në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe rritjen e mobiliteteve të studentëve.</p> <p>Nga takimi me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve , GVJ u njoh me trajnimet dhe shkëmbimet e zhvilluara në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të dokumentuara në Annex 55.</p> <p><i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p> <p><i>Aneksi 44. Faqja e internetit e Departamentit të Administrimit të Biznesit _ Universiteti Epoka</i></p> <p><i>Aneksi 55. Zyrëa për Marrëdhëniet Ndërkombëtare _ Universiteti EPOKA</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>6</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Diploma lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i pavarur shkencor i studentit. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e hartimit të një punimi diplome dhe informon studentët për procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës të reflektuar në Rregullore e Brendshme e FEAS, dhe Udhëzues Diplome e Udhëzues Provimi Përfundimtar.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i></p> <p><i>Aneksi 49. Udhëzues për studentin për provimin përfundimtar të Departamentit të Administrimit të Biznesit</i></p> <p><i>Aneksi 50. Udhëzues mbi punimin e diplomes të programeve universitare</i></p> <p><i>Aneksi 51. Udhëzues mbi shkrimin e temës</i></p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Gjithashtu udhëzon studentët me seanca metodologjike dhe sipas një kalendari takimesh duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Udhëheqësi i punimit të diplomës planifikon një kalendar komunikimi me studentin dhe përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet kohore të realizimit të tij.</p> <p><i>Aneksi 49. Udhëzues për studentin për provimin përfundimtar të Departamentit të Administrimit të Biznesit</i> <i>Aneksi 50. Udhëzues mbi punimin e diplomes të programeve universitare</i> <i>Aneksi 51. Udhëzues mbi shkrimin e temës</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në vlerësimin e diplomës së studentit përveç vlerësimit të cilësisë të punimit, aplikimit dhe zbatimit në praktikë, përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve, dhe njohuria e tij e fushës, komisioni merr në konsideratë edhe njohuritë dhe arritjet akademike të studentit, gjatë tre viteve akademike të ciklit të studimeve.</p> <p>Lidhur me provimin përfundimtar gjithëpërfshirës, studentëve u sigurohen një grup pyetjesh që do të përdoren në provim, së bashku me çelësat e përgjigjeve, për t'i ndihmuar ata në përgatitjen e tyre.</p> <p><i>Aneksi 49. Udhëzues për studentin për provimin përfundimtar të Departamentit të Administrimit të Biznesit</i> <i>Aneksi 50. Udhëzues mbi punimin e diplomes të programeve universitare</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Studenti propozon pedagogun udhëheqës pasi ka marrë paraprakisht dhe aprovimin e tij. Departamenti shqyrton propozimet e studentëve dhe temën dhe garanton që udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit miraton listen e temave dhe udhëheqësve shkencor. Gjatë seancave orientuese me pedagogun studentet asistohen për përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi përmbajtjen e saj nga njësia e programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 49. Udhëzues për studentin për provimin përfundimtar të Departamentit të Administrimit të Biznesit</i> <i>Aneksi 50. Udhëzues mbi punimin e diplomes të programeve universitare</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Studentët kanë në dispozicion infrastrukturën e Universitetit Epoka me laboratorë, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje</p>

<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>elektronike dhe teknologji informacioni, për të realizuar punimet e tyre. Studentët kanë në përdorim programe kompjuterikë të analizimit të të dhënave si Softmogul. Në nivel universiteti, është eksperimentuar për herë të parë në lëndën E-CRM-Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin aplikimi i Sistemit të Menaxhimit të Mikpritjes ofruar nga kompania Softmogul.</p> <p>Studentët kanë akses për shfrytëzimin e bibliotekës fizike dhe bibliotekës elektronike. Aksesi në bazat kryesore të të dhënave të kërkimit si JSTOR, EBSCO etj., lejojnë të zgjedhin artikujt më të mirë të biznesit në përmbajtje të World Economic Forum dhe Harvard Business Review.</p> <p>Pedagogu udhëheqës asiston studentët në realizimin e diplomës dhe vendosjen në zbatim të saj për tregun rajonal deri në përfundim të dorëzimit të saj.</p> <p>Nga bisedat me përgjegjës të departamentit dhe studentët gjatë vizitës në institucion u konstatua se pedagogët udhëheqës të temave të diplomave, asistojnë studentët si në sigurimin e literaturës dhe përpunimin e të dhënave. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Studenti dorëzon kopjen e firmosur të punimit të diplomës në Departament.</p> <p><i>Aneksi 35. Tabelat përmbledhëse për*infrastrukturën</i> <i>Aneksi 49. Udhëzues për studentin për provimin përfundimtar të Departamentit të Administrimit të Biznesit</i> <i>Aneksi 50. Udhëzues mbi punimin e diplomës të programeve universitare</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas Rregullores së FEAS dhe Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe studenti vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë dhe vlerësimi është unanim, por i bazuar dhe në vlerësimin e udhëheqësit. Mesatarja e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të provimit konvertohet në note. Modeli i vlerësimit të tezës gjendet në Annex 52.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 52. Formulari i Vlerësimit të Tezës së Diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit, studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p> <p>Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e</p>

	diplomës të miratuar nga MAS. <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 13.1 Format i diplomës Bachelor IML</i> <i>Aneksi 13.2 Suplementi i Diplomës Bsc IML</i>		
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët e programit Bachelor pajisen me diplomën, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit. <i>Aneksi 13.1 Format i diplomës Bachelor IML</i> <i>Aneksi 13.2 Suplementi i Diplomës Bsc IML</i>		
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga UNIKO për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim. <i>Aneksi 6. Rregullorja e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Epoka, GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të përditësuar për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik", si për personelin

<p>përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme, si për personelin administrative e operacional.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave për personelin në formatin e dosjeve personale, nëpërmjet "Formularit Informues të Personelit". Ky formular është i plotësuar nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme. Formulari ndjek Udhëzimet e Komisionerit Publik "Për të drejtën e Informimit dhe mbojtjen e të dhënave Personale".</p> <p>Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 10.1, Udhëzues mbi rekrutimin e stafit</i> <i>RVB_Bachelor Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e Universitetit Epoka si edhe Rregulloret, përkatësisht të universitetit dhe të fakultetit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në faqen zyrtare web të Universitetit Epoka publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit për çdo vend pune, të cilat janë në përputhje me specifikat e programit të studimit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, bazuar në propozimet e departamenteve dhe fakulteteve, Zyra e Burimeve Njerëzore organizon procedurën për kontraktimin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelin mësimdhënës. Ngarkesa e mësimdhënies është e organizuar nga Udhëzuesi i Univeritetit "EPOKA", "Mbi ngarkesat e Mësimdhënies".</p> <p>Pavarësisht procedurave korrekte të rekrutimit, stafi drejtues i njësisë bazë deklaroi gjatë vizitës në institucion që çështja e rekrutimit të stafit të ri mbetet një sfidë sepse numri i aplikimeve ishte ose i ulët ose kandidatët nuk plotësonin kushtet e aplikimit, kryesisht në drejtim të formimit profesional dhe nivelit të zotërimit të gjuhës angleze.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i></p>

	<p><i>Aneksi 10.1. Udhëzues mbi rekrutimin e stafit</i> <i>Anekset 56-59. Udhëzues mbi rekrutimin dhe format e aplikimit përkatëse.</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e përgjithshme të rekrutimit përcaktohen nga Senati i Universitetit, ndërsa kriteret specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori. Procesi i rekrutimit të personelit fillon bazuar në dispozitat e parashikuara në Shtojcën 10.1 të Rregullores "Për Rekrutimin e Personelit" të Universitetit dhe përcillet nga Zyra e Burimeve Njerëzore: procesi i rekrutimit të personelit akademik bazohet në nevojat e burimeve njerëzore të cilat kërkohen nga të gjitha departamentet dhe njësitë dhe miratohen me vendim të Bordit Administrativ, njësia bazë përkatëse i paraqet Zyrës së Burimeve Njerëzore kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit.</p> <p>Pozicionet e lira shpallen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në faqen zyrtare të internetit të Universitetit, në faqet e agjencive vendase të rekrutimit ose në agjencitë e tjera ndërkombëtare të rekrutimit, në përputhje të plotë me kriteret e parashikuara në Rregulloren "Për Rekrutimin e Personelit".</p> <p>Kandidatët e interesuar aplikojnë online, nëpërmjet formularëve të përcaktuar më parë, pjesë e procedurës standarte. Aplikimet shqyrtohen nga Komiteti Shkencor i njësisë bazë përkatëse, i cili vlerëson përshtatshmërinë e aplikimeve me vendin e lirë, ndërsa sipas rastit, fton kandidatin për të zhvilluar intervistë paraprake online. Kandidatët që plotësojnë kriteret janë të ftuar të zhvillojnë një leksion të hapur para komitetit shkencor. Përfundimisht Komiteti Shkencor e transmeton vlerësimin e tij në Rektorat përmes Dekanatit përkatës. Bazuar në propozimin e Rektoratit, Bordi i Administratimit miraton rekrutimin ose emërimin e kandidatit fitues në vendin e lirë të punës.</p> <p>GVJ konfirmon se institucioni ka përpunuar procedurë të detajuar dhe të qartë në lidhje me rekrutimin e personelit akadmeik, ndihmës akademik si edhe të atij administrativ. GVJ e rikonfirmoi gjykimin e tij pasi shqyrtoi edhe dy dosje aplikimi/rekrutimi, të zgjedhura në mënyrë të rastësishme.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 10.1. Udhëzues mbi rekrutimin e stafit</i> <i>Anekset 56-59. Udhëzues mbi rekrutimin dhe format e aplikimit</i></p>



	<i>përkatëse.</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Epoka, dhe veçanërisht gjatë takimeve me stafin e njësisë bazë, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit që vlerësohet.</p> <p>Mjediset në të cilat zhvillohen aktivitetet mësimore, kërkimore dhe administrative, të këtij programi studimi janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 10.1. Udhëzues mbi rekrutimin e stafit</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Universiteti “EPOKA” I kushton vëmendje të veçantë rritjes së cilësisë, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve akademike dhe kërkuese. Përveç statutit, Universiteti ka hartuar Kuadrin Strategjik, 2018-2022 dhe planin e tij të veprimit, ndërsa Departamenti ka hartuar gjithashtu Kuadrin e tij Strategjik, 2017-2022. Në këtë dokument, drejtimi i parë prioritar është formuluar “Garantimi i ambientit cilësor të mësimdhënies dhe mësimnxënies”. Në përputhje dhe zbatim të këtij qëllimi, institucioni dhe njësia organizojnë programe të vazhdueshme kualifikimi me qëllimin e zhvillimit personal dhe profesional të personelit.</p> <p>GVJ kontaton se personeli akademik inkurajohet me të gjitha mënyrat dhe mjetet, përfshirë edhe mbështetjen financiare, që të marrë pjesë në projekte të Shkëmbimit të Personelit me anë të programit Erasmus+ me universitete të tjera partnere, në konferenca apo projekte kërkimore. Përveç diskutimeve me stafin</p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	

	<p>gjatë vizitës në institucion, vlera e këtyre shkëmbimeve konfirmohet edhe nga dokumenti “Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit (shtojcë 16). Në nivel institucioni janë krijuar udhëzues dhe manuale për të lehtësuar transferimin e përvojës pozitive të krijuar lidhur me përdorimin e metodave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 3. Strategji dhe Plani i Veprimit 2018-2022</i> <i>Aneksi 4. Plani strategjik i Departamentit 2017-2022</i> <i>Aneksi 16. Analiza e vlerës së marrëveshjeve të bashkëpunimit RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Administrim Biznesit (Lista e plotë e personelit 2021-2022), i angazhuar në ofrimin e programit “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” përbëhet nga 22 pedagogë, të cilët realizojnë ngarkesën totale prej 1.808 orë mësimi, ose mesatarisht rreth 90 orë për person. Sidoqoftë ky informacion është i pamjaftueshëm për të gjykuar mbi ngarkesën e plotë të stafit akademik, sepse pedagogët janë të angazhuar në mësimdhënie edhe në departamentet e tjera.</p> <p>GVJ konsideroi ngarkesën e përgjithshme vjetore të tre departamenteve dhe gjykon që edhe pse norma mesatare e ngarkesës është rreth 225 orë për person, fakti që 8 anëtarë të stafit realizojnë normë ngarkese mbi 250 orë në auditor, përbën shqetësim.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> <i>Tabelat shoqëruese, përkatësisht tabelat 1, 4, 6.6, 12.6 dhe 13.</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1563 762 1630">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="762 1563 979 1630">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="979 1563 1197 1630">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1630 762 1680"></td> <td data-bbox="762 1630 979 1680"></td> <td data-bbox="979 1630 1197 1680">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjatë vizitës në Universitetin Epoka, GVJ konstatoi se institucioni ka</p>

zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.

Të dhënat për mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative të Universitetit Epoka, paraqiten si vijon:

Mjedisi	Nr. Sallash/Sipërfaqja
Salla leksioni	20/1883.8
Salla seminari	
Sallë për praktikë lëndore/profesionale	2/182.3
Laborator informatike	3/298.3
Bibliotekë	1/400
Norma m ² /student	6.02
Ambiente ndihmëse	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bibliotekë ▪ Zyra informacioni ▪ Zyra e karrierës ▪ Zyra të tjera që garantojnë aspektin administrativ.

Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në intervalin orar 8.00-14.00.

RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik
Tabelat shoqëruese, përkatësisht tabela 16.
Vizita në institucion.

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave

Infrastruktura e Universitetit është moderne dhe e përshtatshme për të zhvilluar procesin akademik, sipas kërkesave bashkëkohore. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv mësimor në përputhje me qëllimet e programit. Katër laboratorë kompjuterikë të pajisur plotësisht janë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve për të zhvilluar aktivitetet e programit.

Çdo semestër, bazuar në kërkesat e personelit akademik, Zyra Koordinuese të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICTC) përditëson programet në laboratorët e kompjuterave.

Programi Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik ka disa kërkesa specifike për pajisje dhe mjete pune, për shkak të natyrës së tij, si një kurs ndërmjet teknologjisë dhe Administrimit. Pavarësisht kësaj, GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se

formues të programit të studimit në tërësi.	Teknologjia bashkëkohore është plotësisht e aksesueshme nga studentët, duke iu mundësuar efektivitetin më të lartë të procesit.		
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	<p>Gjithashtu, GVJ u informua se për të mbështetur studentët në studimet e tyre, institucioni ka siguruar një gamë e gjerë softuerësh, përkatësisht:</p> <p>Windows: MS Office, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 fundit, Multisim 11, VMW are Workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + -MAX, SPSS, EViews, etj.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> <i>Tabelat shoqëruese, përkatësisht tabela 16.</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB si dhe informacionit të marrë takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat e parashikuara në programin e studimit “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik”.</p> <p>Aktualisht, për të mundësuar kryerjen e praktikës profesionale për studentët, institucioni ka dakordësuar rreth 44 marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private, institucione publike, organizata jo-fitimprurëse dhe 98 të tilla me institucione akademike.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni dhe njësia bazë kanë garantuar mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p><i>Aneksi 15. Lista e Bashkëpunimeve Institucionale.</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Universiteti Epoka vë në dispozicion të gjithë studentëve dhe stafit të tij,

<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>bibliotekën e universitetit, e cila ndodhet tek kati i parë i Godinës A, me kapacitet 100 vende, në një sipërfaqe 400m², 25 mijë tituj dhe 2mijë revista akademike dixhitale.</p> <p>Institucioni ka mundësuar aksesin edhe tek burime të tjera online që përfshijnë revista të njohura, me numër të lartë rankimi si Journals Cambridge Online, IOPscience, New England Journal of Medicine, OECD- iLibrary, Taylor & Francis Library. Literatura ofrohet në tre gjuhë, përkatësisht shqip, anglisht dhe turqisht.</p> <p>Duke u mbështetur tek kërkesat e syllabuseve për literaturë bashkëkohore, institucioni siguron një numër të konsiderueshëm të teksteve të detyrueshme dhe literaturës plotësuese.</p> <p>GVJ, përgjatë analizës të dosjes të vlerësimit konstatoi se shtojca 17 përmban një listë të detajuar të titujve të librave, të nevojshëm për të plotësuar njohuritë mbi marketingun. GVJ konfirmon se studentët mund të aksesojnë lirisht, pa asnjë kufizim dhe pa kosto, literaturën e nevojshme. GVJ gjithashtu konstatoi se Institucioni ka garantuar akses në sistemin JSTOR, për çdo anëtar të personelit të Universitetit “EPOKA”, gjë që iu mundëson atyre të reflektojnë literaturën më bashkëkohore gjatë mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në vijim të informacionit të konfirmuar tek kriteri 1, GVJ konstatoi se koleksioni i bibliotekës, përveç se është i organizuar sipas fushave dhe temave, pasurohet me blerje dhe dhurime nga persona të ndryshëm fizikë dhe juridikë.</p> <p>GVJ gjithashtu vlerësoi procedurën institucionale të pasurimit të bibliotekës me tituj të kërkuar nga personeli akademik, në përputhje me nevojat e studentëve. Është përgjegjësi e koordinatorëve të programeve dhe përgjegjësive të departamenteve që të hartojnë plan të detajuar të nevojave për literaturë, gjë e cila realizohet plotësisht nga njësia bazë.</p> <p><i>Aneksi 17. Lista e librave të marketingut.</i> <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka krijuar kushte plotësisht të përshtatshme dhe ka garantuar aksesin e barabartë të studentëve tek materialet e bibliotekës, fizike dhe online, pa kufizime dhe pa kosto financiare.</p> <p><i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka është e paisur me programe kompjuterike bashkëkohore, të cilat lejojnë aksesimin e literaturës së nevojshme nga studentët, dhe në një kohë të shkurtër, duke mundësuar proces studimi efektiv. Këtu përfshihet sistemi I kondicionimit, sistemi kompjuterik, internet, WI-FI etj.</p>

	<i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik Vizita në institucion.</i>		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Siç u sqarua tek kriteri 3, institucioni aplikon një procedure të përcaktuar për të plotësuar nevojat e bibliotekës. Procedura parashikon blerjen e librave, aktivitet që koordinohet dhe realizohet nga njësia e bibliotekës nën koordinimin e Zyrës Koordinuese të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, sipas kërkesës me shkrim të departamentit. GVJ konfirmon rregullsinë dhe saktësinë e procedurës të pasurimit të bibliotekës.		
	<i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik Vizita në institucion.</i>		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga vizita në institucion, GVJ u informua se orari i bibliotekës është përcaktuar në përputhje me orarin zyrtar të institucionit, përkatësisht nga e hëna në të premte, prej orës 08:30 deri 16:30, me një pushim dreke prej 30 minuta. Orari është plotësisht I përshtatshëm për studentët.		
	<i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik Vizita në institucion.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pafullësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion dhe takimet me personat përgjegjës, GVJ konstatoi se Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit është struktura që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Detyrat specifike të kësaj zyre janë përcaktuar tek neni 27 i Rregullores së Universitetit. Gjatë takimit me sekretarinë GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen fizike të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” dhe konstatoi plotësinë e tyre si dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar & të arritjeve akademike) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Përveç dokumentacionit dhe arkivës letër, GVJ konstatoi se në faqen web të Universitetit Epoka është integruar Sistemi EIS, një shërbim software, sistemi kryesor i brendshëm i administrimit

	<p>institucional i zhvilluar nga Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Universitetin “EPOKA” për të menaxhuar të gjitha informacionet që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga viti i parë i regjistrimit deri në diplomimin e tyre përfundimtar.</p> <p>EIS është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Institucioni ka përgatitur dhe përdor dy udhëzues në lidhje me përdorimin e sistemit EIS, përkatësisht një për lektorët dhe një tjetër për studentët.</p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ konfirmoi se studentët e konsiderojnë mjaft të përshtatshëm dhe efektiv sistemin EIS, nëpërmjet të cilit realizojnë komunikimin administrative dhe akademik, në përputhje të plotë me nevojat e tyre.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullorja bazë e Universitetit EPOKA</i> <i>Aneksi 18.1 Udhëzues EIS – Pedagogët</i> <i>Aneksi 18.2. Udhëzues EIS – Studentët</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në Universitetin Epoka, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” realizohet nga disa struktura në varësi të natyrës së informacionit.</p> <p>GVJ u informua dhe konstatoi edhe si rrjedhojë e analizës së dokumentacionit të vënë në dispozicion, se Sekretaria e Përgjithshme, drejton aktivitetin e Sekretarive të fakulteteve, ndërsa këto të fundit janë njësitë e ngarkuara me menaxhimin dhe administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik (neni 28, Rregullore Bazë e Universitetit Epoka). Detyrat e njërive të tjera administrative janë të parashikuara tek “Rregullorja e organizimit administrativ të universitetit“ (neni 29, Rregullorja bazë e Universitetit Epoka“). Ky dokument nuk është në listën e dokumentave që përbëjnë dosjen e vlerësimit. Elementë të funksionimit administrativ janë përshkruar në Statut, Seksioni VIII „Bordi Administrativ“, nenet 39 deri 44.</p> <p>GVJ tërheq vëmendjen mbi mungesën e dokumentacionin që pasqyron organizimin dhe funksionimin administrativ të institucionit, për rrjedhojë dhe mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit mbi personelin administrativ dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të tyre. Gjithashtu, GVJ konstatoi se mungojnë evidenca të mbledhjeve, qoftë në nivel departamenti,</p>

	<p>qoftë fakulteti. Këto evidenca do të hidhnin dritë mbi çështjet e diskutuara, vendimet e marra si edhe kryerjen e detyrave nga ana e stafit.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullorja bazë e Universitetit EPOKA RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Siç u argumentua edhe tek vlerësimi I standartit sipas kriterit 1, GVJ rikonfirmon se EIS, si një sistem interaktiv online, iu mundëson përdoruesve, personel dhe studentë, akses të barabartë, të menjëhershëm, në informacionin e tyre personal, nëpërmjet të cilit mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me detyrat e tyre, në përputhje me pozicionin dhe rolin në institucion. Nëpërmjet shqyrtimit të RVB dhe diskutimeve gjatë takimeve në institucion, GVJ u informua se përveç EIS, studentëve iu shërben në përputhje të plotë me nevojën e tyre dhe realizimin e detyrimeve akademike, edhe Sistemi i Menaxhimit të Mësimin (LMS) një tjetër sistemi i bazuar në Moodle, si edhe si edhe Google Classroom. Këto sisteme, që ofrohen për studentët dhe lektorët, mundësojnë koordinimin dhe organizimin e materialeve të lëndëve si edhe komunikimin interaktiv të tyre.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni, nëpërmjet platformave të integruara, ka siguruar kushtet më të mira për menaxhimin dhe përdorimin efektiv të informacionit si edhe komunikimin interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Përveç sistemeve të mësipërme, GVJ konstatoi se në faqen web të Universitetit Epoka (https://eis.epoka.edu.al/cv/fullcv/241) janë integruar faqet individuale web të pedagogëve të Universitetit. Në këto faqe web, lehtësisht të përdorshme nga të gjithë të interesuarit, jepen informacione të detajuara lidhur me lëndët që mbulon secili pedagog në programe të ndryshme të studimit (syllabuese, prezantime të leksioneve në powerpoint, materiale ndihmëse, informacione mbi detyrat e kursit, detyrimet e tjera lidhur me programin mësimor etj).</p> <p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të Universitetit Epoka garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik Vizita në institucion. https://eis.epoka.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të institucionit publikohet në gjuhën shqipe dhe angleze informacioni i nevojshëm mbi</p>

studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit.		
	https://www.epoka.edu.al/		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	RVB është i vetmi dokument që dëshmon se institucioni harton raport financiar të kostove të programit. Ndonëse tek dosja e vlerësimit të programit dorëzuar tek ASCAL, është përfshirë <i>aneksi 20, Shpenzimet Bachelor MNML</i> , dokumenti nuk sjell asnjë informacion në lidhje me kostot. GVJ konfirmon se është e pamundur të gjykohet mbi kostot e programit për shkak të mungesës së informacionit. <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Për shkak të mungesës së informacionit, GVJ nuk mund të gjykojë mbi planin e financimit të programit që vlerësohet. <i>RVB_Bachelor_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve	RVB sqaron se Turgut Ozal Education sh.a kryen një audit vjetor të jashtëm në lidhje me situatën financiare të institucionit, ndërsa raporti i detajuar mund të gjendet në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a. Por GVJ nuk disponon këtë raport dhe as ndonjë raport tjetër mbi të ardhurat nga çdo burim i mundshëm dhe shpenzimet për shërbimet, për rrjedhojë nuk mund të komentojë mbi situatën financiare të institucionit.

financiare.	<i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i>		
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Si edhe më sipër, ndonëse RVB konfirmon se raporti financiar është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet në këtë Drejtori, ndërsa të dhënat dhe analizat i komunikohen Universitetit “EPOKA”, dhe ruhen në Zyrën e Financës dhe në Zyrën e Administratorit, GVJ nuk ka akses tek këto dokumenta. <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i>		
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	GVJ nuk mund të komentojë mbi qëndrueshmërinë financiare të institucionit për shkak të mungesës së dokumentacionit. Tek dosja e vlerësimit të programit janë përfshirë dy raporte vjetore të departamentit Administrim Biznesi, përkatësisht 2017-2018 dhe 2018-2019. Së pari, këto dy raporte janë të pamjaftueshme për të dëshmuar pasqyrën financiare të aktivitetit sepse duhet të përfshihet edhe informacioni për periudhën 2019-2020 dhe 2020-2021. Së dyti, informacioni financiar nuk është i plotë. Ai tregon vetëm të ardhurat nga <i>tuition and fees</i> dhe shpenzimet për paga, investime dhe të tjera operationale, totaliteti i të cilave nuk korespondojnë. Ndonëse raportet vjetore të institucionit janë të aksesueshme në faqen web të Universitetit Epoka, dhe këto raporte përmbajnë një kapitull të shkurtër të burimeve financiare, informacioni i paraqitur aty është krejtësisht i pamjaftueshëm për të lejuar vlerësimin dhe komentimin e shkallës së realizimit të standartit IV.6 <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve


<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti Epoka ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin e parë të studimeve universitare në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kopetenca profesionale e analitike.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MAS në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës.</p> <p>Politikat dhe procedurat e hartuara reflektohen në Statutin e Universitetit Epoka; Rregulloren e Brendshme të FEAS ; Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5. Rregullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja themelore e Universitetit EPOKA dhe e programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e Universitetit Epoka dhe rregulloren e FEAS.</p> <p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e studimeve 3-vjeçare Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik përcaktohen nga MAS për vitin akademik përkatës dhe publikohen nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. Sipas rregullores së Universitetit Epoka pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për ata që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional, si dhe kandidatët që disponojnë diplomën e shkollës së mesme jashtë vendit (të ekuivalentuar nga MAS).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Ndër kriteret e veçanta të kandidatëve për tu pranuar në ciklin e parë të studimeve është dhe dëshmia e nivelit të aftësive në gjuhën angleze B1.</p>

	<p>Të gjitha informacionet e pranimit, transferimit, regjistrimit, tarifave, bursat dhe transferimin e studentëve janë publikuar në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të institucionit.</p> <p><i>Aneksi 5. Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i></p>						
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Shtetasit shqiptarë, shqipëtarët jashtë kufijve shtetërorë, si dhe shtetasit e huaj kanë të drejtën të ndjekin studimet vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara nga MAS, statuti i EPOKA dhe rregulloret përkatëse në lidhje me studimet e ciklit të parë.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5. Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i></p>						
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Studentët mund të gjejnë informacionin e duhur në fakultet, departamente dhe në çdo strukturë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përputhje me aktet rregullative në fuqi, institucioni kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti Epoka udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit përmes websitit të tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit dhe takimeve me studentët potencialë. Nga vizita në insitucion GVJ u njoh me planin e aktivitete të informimit të maturantëve nga Zyra e Pranimit përpara fillimit të vitit akademik. Ato zhvillojnë aktiviteteve informuese për kandidatët ku bëhen prezantime rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi, njohjen me të gjitha ambientet fizike të universitetit. GVJ u njoh me guidës e studentit si material që ka informacionin e nevojshëm në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në Universitetin Epoka.</p> <p><i>Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022</i> <i>Aneksi 9.2. Procedurat standarde të funksionimit të zyrës së regjistrimit.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="561 1892 746 1962">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="746 1892 970 1962">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="970 1892 1193 1962">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="561 1962 746 2007"></td> <td data-bbox="746 1962 970 2007"></td> <td data-bbox="970 1962 1193 2007" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në rregulloren e Universitetit dhe të FEAS. Ky informacion vihet në dispozicion nga Zyra e pranimeve dhe Sekretaria e institucionit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, njëسيا bazë përgjegjëse së bashku me dekanatin dhe Zyra e pranimeve organizojnë takime informuese ku ju shpjegojnë në detaje përbërjen e Universitetit EPOKA, strukturat e tij, përbërja dhe struktura e Fakultetit dhe departamentit. Gjithashtu bëhet edhe prezantimi me infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky program studimi. Studentët informohen edhe nëpërmjet planit mësimor për strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra të tyre, të disponueshme dhe përmes sistemit EIS. Informacioni i plotë dhe i përditësuar për strukturën institucionale dhe programet e studimit mundësohen nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale.</p> <p><i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 9.2. Procedurat standarde të funksionimit të zyrës së regjistrimit.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Universiteti Epoka informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme nëpërmjet sekretarisë mësimore, zyrës së pranimeve, njësisë së koordinimit të studentëve dhe departamentit përkatës të programit të studimit. Kriteret dhe procedurat e transferimit përcaktohen në Rregulloren e insitucionit dhe të programit të studimit dhe bëhen publike përmes faqes web të Universitetit Epoka si dhe vihen në dispozicion të studentëve përmes sekretarisë mësimore dhe drejtuesit të njësisë bazë.</p> <p><i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Universiteti Epoka informon studentët lidhur me vlerësimin e dijeve nëpërmjet Rregullores së Programit të studimit ku paraqiten:</p> <p>Sistemi i vlerësimit; forma e vlerësimit; forma e kontrollit të dijeve; kushtet për hyrjen në provim; organizimin e provimeve;</p>



	<p>shpalljen e rezultateve; ankimimin dhe rishikimin e notës.</p> <p>Në programet e secilës lëndë ka informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve. Studentët e aksesojnë informacionin dhe në distance përmes sistemit EIS dhe fizikisht pranë departamentit të programit të studimit. Në fillim të çdo semestri, programi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve shpjegohen nga pedagogu i lëndës përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, guida e studentit u dorëzohet të gjithë studentëve të regjistruar me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka u vendos në dispozicion studenëve udhëzues të shkruar mbi kriteret e procedurat e punimit të diplomës, të miratuara nga Departamenti dhe paraqitura tek Udhëzuesi i diplomës. Gjithashtu siç u sqarua ne fushën III gjatë periudhës së përgatitjes të punimit te diplomes zhvillohen seancat metodologjike dhe pedagogu udhëheq studentëve për punim e diplomës.</p> <p><i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 50. Udhëzues i punimit të diplomës</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, Universiteti Epoka zhvillon takime orientuese nëpërmjet të cilave studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Pjesë e tyre është dhe Dita e Informimit të Maturantëve ku janë organizuar takime të hapura informuese me maturantë nga Zyra e Pranimeve.</p> <p>Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e studimit.</p> <p><i>GVJ inkurajon më shumë përpjekje nga institucioni në drejtim të marketimit të programit të studimit Bachelor Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik, me qëllim forcimin e programit të studimit në të ardhmen.</i></p> <p><i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="571 1921 762 1989">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="762 1921 979 1989">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="979 1921 1197 1989">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		



së standardit

X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.

Departamenti i Administrim Biznesit informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, nëpërmjet rregullores së programit të studimit. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve nga web i Universitetit Epoka, Zyra e pranimeve, Sekretaria Mësimore ku studentët mund të marrin informacion të hollësishëm, lidhur me organizimin e plotë të studimeve të programit të studimit si dhe për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.

Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022

Aneksi 43 Programi i Javës Orientuese

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Universiteti Epoka informon studentët në lidhje me programin e studimit, procesin mesimor, rregulloren e brendshme, rregulloren e studimeve, procedurat e procesit mesimor etj., nëpërmjet zyrës së pranimeve dhe koordinatorëve si dhe në mënyrë elektronike në sistemin EIS, dhe në websit-in e institucionit. Në fillim të çdo semestri studentët pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve.

Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022

Aneksi 43 Programi i Javës Orientuese

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.

Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me koordinatorët për studentët, informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për të orientuar në tregun e punës.

Aktivitetet e punësimit të studentëve përfshijnë Panairë pune nga Shërbimi kombëtar i punësimit; Biznese të ftuar në auditor; aktivitete Alumni, dhe bashkëpunime me organizma dhe biznese lokale. Institucioni përmes Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni inkurajon studentët të marrin pjesë dhe informon ata mbi zhvillimet në tregun e punës.

Aneksi 25. Strategjitë e Punësimit


Aneksi 30. Universiteti EPOKA Raporte Vjetore

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e

Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, Universiteti Epoka zhvillon "Javën e Informimit", nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me

<p>procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>programet e studimit, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Gjatë kësaj jave zhvillohen takime informuese të organizuara nga Drejtuesi i njësisë së programit në bashkëpunim me Zyrën e Pranimeve dhe Koordinatorët për studentët.</p> <p>Studentët e regjistruar pajisen me një udhëzues praktik (Aneksi 9.1) me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e studimit.</p> <p><i>Aneksi 9.1. Udhërrëfyese për studentët, 2021-2022</i> <i>Aneksi 43 Programi i Javës Orientuese</i></p>		
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për studentët, në Universitetin Epoka monitorohen dhe menaxhohen nga një sistem i brendshëm i mirëorganizuar EIS, zhvilluar nga Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Universitetin “EPOKA”.</p> <p>Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes EIS ku pedagogë e student shkëmbejnë materiale të ndryshme lidhur me lëndën dhe programin e studimit.</p> <p>Në sistemin EIS studentët mund të hynë në kurrikulën e programit, listën e notave, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet. Ky sistem i ndihmon të monitorojnë veprimtarinë akademike dhe planifikojnë programin e tyre javor.</p> <p>GVJ vlerëson se Universiteti Epoka disponon një sistem të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distancë.</p> <p><i>Aneksi 18.1 Udhëzues EIS – Pedagogët</i> <i>Aneksi 18.2. Udhëzues EIS – Studentët</i> <i>Aneksi 68. Shërbime Zyre ICTC</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon</p>	<p>Universiteti Epoka disponon dhe mban statistika vjetore për</p>



<p>dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit të konstatuara nga GVJ në sekretarinë e njësisë në formë elektornike dhe fizike përmes regjistrave të lëshimit të diplomave. Nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni po sigurohen kontakte me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e arritjeve profesionale të tyre por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.</p> <p>Sipas RVB <i>Tabela Përmbledhëse</i> dhe vizitës së GVJ në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve në këtë program studimi në vitet akademike ishte:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 : 33 studentë Për vitin akademik 2020-2021 : 33 studentë Për vitin akademik 2019-2020 : 42 studentë + 1 të transferuar Për vitin akademik 2018-2019 : 35 studentë + 1 të transferuar Për vitin akademik 2017-2018 : 23 studentë + 2 të transferuar</p> <p>Për sa i përket numrit të të diplomuarve në këtë program studimi rezulton se:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar gjithsej 27 studentë Për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar gjithsej 19 studentë; Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar gjithsej 19 studentë; Për vitin akademik 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 8 studentë;</p> <p><i>Aneksi 14. Të dhëna përmbledhëse për transferimin e studimeve RVB, Tabela Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat për studentët e regjistruar, të diplomuar, kalueshmeria në vite gjenden pranë sekretarisë mësimore. GVJ konstatoi se Sekretaria mësimore disponon dosjet për çdo student, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e maturës shtetërore, listë notash, kontrata dhe aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, dy fotografi. Statistikat e studenëteve disponohen në formë elektronike dhe fizike në sekretarinë e njësisë.</p> <p><i>Aneksi 14. Të dhëna përmbledhëse për transferimin e studimeve RVB, Tabela Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ ju vunë në dispozicion regjistri themeltar, regjistri i rezultateve të arritura nga studentet të programit, të cilët rezultuan të plota dhe në përputhje me kërkesat ligjore për to. Të dhënat në regjistrat janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar, në përputhje me aktet normative të ruajtjes së të dhënave personale të Universitetit Epoka. Të dhënat statistikore për programin e studimit menaxhohen nga sekretaria mësimore dhe departamenti</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e</p>	

<p>autorizuar.</p>	<p>Administrim Biznes. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj., bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e Universitetit Epoka. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy dhe përdoren si për analiza të aspekteve specifike ashtu dhe në kuadër të raportit vjetor në nivel fakulteti dhe universiteti.</p> <p>I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në sistemin EIS dhe aksesohet vetëm përmes studentit sipas numrit të matriculimit të tij. Sistemi mban të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student me programin që ndjek.</p> <p><i>Aneksi 18.2. Udhëzues EIS – Studentët</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar takimeve në insitucion dhe dokumentacionit të paraqitur, rezulton se departamenti harton raportin vjetor të analizës mësimore mbi programin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre. Departamenti reflekton mbi gjendjen aktuale dhe bazuar në këto të dhëna propozon masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni informojnë lidhur me shkallën e punësimit të studentëve sipas programeve të studimit. Kjo njësi ofron shërbim të plotë të menaxhimit të karrierës, mbështetje në kërkimet e punësimit gjatë të gjithë periudhës së studimit, njoftime punësimi periodike si dhe ndihmë konkrete rreth mënyrës së kërkimit të punës dhe përgatitjes së CV dhe dokumenteve të tjerë të rekrutimit.</p> <p><i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët kanë mbështetjen e Universitetit Epoka për tu angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Nga takimi në institucion u informuam se studentët organizohen në Keshillin Studentor, në takime për vlerësimin e procesit mësimor dhe dhënë ide për përmirësime të vazhdueshme në përputhje me nevojat e tyre si dhe në procesin e</p>

	<p>anketimit për vlerësimin për lëndët dhe pedagogun.</p> <p>GVJ konfirmon se studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatit Akademik dhe në komisione të përhershme si KPSC e KPMS dhe në Bordin e Etikës, sipas përcaktimeve në statutin e Universitetit Epoka dhe rregullore e FEAS nëpërmjet të cilave është garantuar përfaqësimi i studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Universiteti Epoka garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët organizohen në Këshilla Studentore ku shprehin mendimin e tyre për problematika të ndryshme lidhur me çështje të programeve mësimore dhe procesit mësimor. Gjithashtu KPSC organizon anketime me studentët, përmes të cilave mendimet dhe propozimet e studentëve u paraqiten departamentit dhe merren masat përkatëse korrigjuese.</p> <p>Përfaqësuesit e Këshillit Studentor janë anëtarë të Senatit Akademik, Bordit të Etikës, Komisionit të Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe problemet e tyre adresohen drejtpërdrejt në instancat përkatëse.</p> <p>Nga takimi me studentët mësuam se ata janë në djeni të këtyre strukturave dhe i mbështesin ato.</p> <p>Këshilli studentor i Universitetit Epoka është organ kolegjal, me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët në mënyrë demokratike. Këshilli studentor ka komunikim institucional me strukturat e tjera për të përcaktuar në mënyrë e drejtpërdrejtë e për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Ai ka qëllim zhvillimin akademik të studentëve ashtu edhe rritjen e tyre sociale dhe personale.</p> <p>Aktivitetet e Studentëve mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit. Studentët shprehin mendimet e tyre për procesin mësimor dhe për aspekte që lidhen konkretisht me studentin, nëpërmjet anëtarësimeve në bordet e sipërpërmendura institucionale, vlerësimeve semestrale, takimeve informale, nëpërmjet Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore. Rezultatet e veprimtarisë së tyre janë të evidentuara dhe konfirmuara nga institucioni.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5.Regullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i></p>

	<p><i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar njohuritë. Në vlerësimin e ngarkesës akademike janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik ashtu dhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e studentëve gjatë kursit.</p> <p>Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikat e plota të njohjes së lëndëve dhe ka procedura joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme. Në dokumentat rregullative në nivel universiteti, fakulteti dhe programi të studimit është parashikuar procesi i transferimit të studimeve (njohje të pjesshme ose e plotë e studimeve) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për këtë aspekt.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 5. Rregullorja e Universitetit Epoka</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 60. Udhëzues për transferimin e studimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët në mënyrë indirekte përfshihen në rishikimin e syllabuseve apo të programit Bachelor "Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik". Kjo për faktin se studentët angazhohen në vlerësimin e përfundimit të pedagogëve përmes Anketës së Vlerësimit të Instruktorit të Lëndës dhe në dobinë e disiplinës akademike përmes anketimeve nga KPSC.</p> <p>GVJ konstaton që institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit dhe vlerësimet e sugjerimet e tyre pasqyrohen në raportin vjetor të departamentit.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 32. Raporti Vjetor viti akademik 2018-2019 departamenti BUS</i> <i>Aneksi 64. Anketa mbi kënaqshmërinë e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit,</p>	<p>Studentët përmes anketimeve dhe focus grupeve të realizuara nga institucioni mund të japin mendimin e tyre mbi kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve. Anketa e Vlerësimit të Instruktorit të Lëndës, e cila është një element i rëndësishëm që përdoret për përmirësimin e aktiviteteve mësimdhënëse.</p>




rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjithashtu, nga vizita në institucion GVJ u informua se pas çdo provimi pedagogu vendos seanca sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit. <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i> <i>Aneksi 64. Anketa mbi kënaqshmërinë e studentëve</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; Sekretaria mësimore ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; Zyra e karrierës dhe Alumni ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. Mbi çështje administrative, informohen nga Dekani i studentëve dhe Administratori i Universitetit. Universiteti Epoka ka krijuar procedurë në shërbim të informimit të studentëve në përputhje rregullatore e institucionit. <i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 7. Rregullorja "Studimet universitare dhe provimet"</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Universiteti Epoka ka një sistem online për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Sistemi Interaktiv EPOKA (EIS) ofron informacion të përditësuar për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin si një mjet për informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatorët. Gjithashtu Universiteti Epoka ka ngritur zyrën e pranimeve të studentëve dhe koordinimit për asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. <i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>Aneksi 6. Rregullore e FEAS</i> <i>Aneksi 9.1. Udhërrëfytyrë për studentët, 2021-2022</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni luan rol të rëndësishëm në këshillimin dhe orientimin e studentëve në mënyrë të vazhduar dhe periodike për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Përmes seminareve, konferencave dhe projekteve bashkëpunuese me biznesin, Universiteti Epoka shkëmben informacion lidhur me njohuritë dhe aftësitë që ofron programi i studimit dhe profilet në tregun e punës.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni u dallua se bëhen përpjekje rigoroze për krijimin e mundësive për aktivizimin e studentëve pranë kompanive duke i zhvilluar ata me standardet dhe kushtet e tregut të punës.</p> <p><i>Aneksi 47. Uebfaqja e Departamentit të Planifikimit të Karrierës dhe Zyrës së Alumni - Universiteti Epoka</i></p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit. GVJ nga vizita në institucion u informua se Departamenti i Administrim Biznesit ka rrjetin e tij në tregut të punës të cilët sigurojnë informacion dhe ua vënë në dispozicion organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>Gjithashtu Anketa e të Diplomuarve zhvillohet çdo vit nga Universiteti “EPOKA” dhe rezultatet ndihmojnë programin përkatës të studimit.</p> <p><i>Aneksi 27. Anketa e Alumni 2019-2020</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës</p> <p>V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet</p>	<p>Shqyrtimi jo vetëm i RVB por i çdo dokumenti të përgatitur nga njësia bazë dhe të përfshirë në dosjen e vlerësimit, dëshmon se Universiteti “EPOKA” i kushton vëmendje të veçantë menaxhimit dhe administrimit të aktivitetit nëpërmjet politikave</p>

ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

dhe procedurave të institucionalizuara, që rregullojnë funksionimin efektiv të institucionit, dhe nëpërmjet tij, edhe të njësisë bazë.

Institucioni ka krijuar dhe forcuar vazhdimisht Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, të miratuar me vendim të Senatit. Sistemi përbëhet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, së bashku me nën-njësitë e tij si: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve. Funksionimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë është përcaktuar në statutin e Universitetit "EPOKA", rregulloren për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë si dhe në manualin e sigurimit të cilësisë të Universitetit "EPOKA".

GVJ konstaton se institucioni plotëson më së miri kërkesat e legjislacionit për garantimin e cilësisë.

Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s, neni 35 & 37.

Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPPK-së

Aneksi 61. Politika e Cilësisë.

Aneksi 63. Manuali i Sigurimit të Cilësisë.

RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.

Vizita në institucion.

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Në takimin me drejtuesen e Departamentit të Administrim Biznesit si edhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se Universiteti Epoka përdor procedura formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale.

Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për të njohur nivelin e kënaqshmërisë të studentëve. Sipas RVB, institucioni realizon Vlerësim të Jashtëm të Cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit.

GVB paraqiti evidenca shtesë Shtojcë 20 që dëshmon mbi opinionet e studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në institucion.

Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s, neni 35 & 37.

Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPPK-së

Aneksi 61. Politika e Cilësisë.

Aneksi 63. Manuali i Sigurimit të Cilësisë.

	<p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 20 Survey on curricula changes</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni njeh dhe synon përdorimin e instrumentave të duhur për sigurimin e cilësisë. GVB paraqiti Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS si instrument për vlerësimin e cilësisë së procesit akademik.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s, neni 35 & 37.</i> <i>Aneksi 8.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e KPPK-së</i> <i>Aneksi 61. Politika e Cilësisë.</i> <i>Aneksi 63. Manuali i Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Aneksi 64. Anketa mbi kënaqshmërinë e studentëve</i> <i>Aneksi 65. Studim mbi kënaqshmërinë e stafit.</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë të qartë e të mirë organizuar, e cila, nëse zbatohet në mënyrë rigoroze, do të ndihmojë në garantimin e cilësisë.</p> <p>GVB ka paraqitur dokumentacion plotësuese, përkatësisht Shtojcat 1,2,3,4,5,6 për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Aneksi 64. Anketa mbi kënaqshmërinë e studentëve</i> <i>Aneksi 65. Studim mbi kënaqshmërinë e stafit.</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 2 Vendimi I Rektoratit mbi Raportin dhe rekomandimet e dhëna nga bordi i provimeve.pdf</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 3. raporti-vjetor-2020-2021</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 4 The Action Plan in Response to the Recommendations</i> <i>Shtojca Plotësuese Nr. 5 Evidenca mbi diskutimet në nivel departamenti mbi propozimet mbi kurrikulen</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentave të dosjes të shqyrtuara nga GVJ, departamenti është përgjegjës për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit, i cili monitoron dhe rishikon programet, nëse paraqitet e nevojshme. Propozimet e departamentit analizohen nga dekanati.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni ka krijuar njësi të posaçme, përkatësisht Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave, që merr propozimet nga dekanati, si edhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin të Cilësisë, tek I cili dërgohen përfundimisht propozimet për ndryshim, e më pas në, dërgohen tek Senati Akademik që merr vendimin përfundimtar në lidhje me përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>GVB ka paraqitur dokumentacion plotësues, përkatësisht Shtojcat 1,2,3,4,5,6 mbi shkallën e përdorimit të mekanizmave dhe efektivitetin e proceseve formale.</p> <p>GVJ inkurajon njësinë përgjegjëse për vlerësim dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi 11.2. Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit</i> <i>RVB_Bachelor Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 2 Vendimi I Rektoratit mbi Raportin dhe rekomandimet e dhëna nga bordi i provimeve.pdf</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 3. raporti-vjetor-2020-2021</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 4 The Action Plan in Response to the Recommendations</i> <i>Shtojca Plotësuese Nr. 5 Evidenca mbi diskutimet në nivel departamenti mbi propozimet mbi kurrikulen</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Pavarësisht argumentimit të paraqitur nga grupi vlerësimi të brendshëm në RVB, GVJ konfirmon qartazi, siç dhe është pozicionuar në lidhje me vlerësimin e standartit VI.1 dhe VI.2, kriteret 1&2, se institucioni ka hartuar politika të mirëformuluara në lidhje me sigurimin e cilësisë, por raportet mbi shkallën e zbatimit të këtyre politikave, si edhe çështjet më kritike,</p>

	<p>mungojnë.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 2 Vendimi I Rektoratit mbi Raportin dhe rekomandimet e dhëna nga bordi i provimeve.pdf</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 3. raporti-vjetor-2020-2021</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 4 The Action Plan in Response to the Recommendations</i></p> <p><i>Shtojca Plotësuese Nr. 5 Evidenca mbi diskutimet në nivel departamenti mbi propozimet mbi kurrikulen</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVB ka paraqitur dokumentacion plotësuese, përkatësisht Shtojcat 1,2,3,4,5,6 mbi dokumentimin e rezultateve drejt autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 2 Vendimi I Rektoratit mbi Raportin dhe rekomandimet e dhëna nga bordi i provimeve.pdf</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 3. raporti-vjetor-2020-2021</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 4 The Action Plan in Response to the Recommendations</i></p> <p><i>Shtojca Plotësuese Nr. 5 Evidenca mbi diskutimet në nivel departamenti mbi propozimet mbi kurrikulen</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVB ka paraqitur dokumentacion plotësuese, përkatësisht Shtojcat 1,2,3,4,5,6 mbi dokumentimin e rezultateve për vlerësimin e cilësisë.</p> <p>GVJ inkurajon njësinë për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë bazuar në raportet mbi shkallën e zbatimit të këtyre politikave.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 2 Vendimi I Rektoratit mbi Raportin dhe rekomandimet e dhëna nga bordi i provimeve.pdf</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 3. raporti-vjetor-2020-2021</i></p> <p><i>Shtojca plotësuese Nr. 4 The Action Plan in Response to the</i></p>

	<i>Recommendations</i> <i>Shtojca Plotësuese Nr. 5 Evidenca mbi diskutimet në nivel departamenti mbi propozimet mbi kurrikulen</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstatoi se Njësia bazë ka zbatuar me përpikmëri legjislacionin në fuqi në lidhje me vlerësimin e brendshëm të programit për efekt të riakreditimit. Raporti I Vlerësimit të brendshëm sëbashku me shtojcat është vënë në dispozicion të GVJ.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ konstaton se përveç këtij vlerësimi, nuk është kryer ndonjë vlerësim tjetër dhe as studim, as studim tregu, para hapjes së programit apo gjatë zbatimit të tij, si edhe as ndonjë vlerësim tjetër, i lidhur drejtëpërsëdrejti apo jo drejtëpërsëdrejti me cilësinë e programit.</p> <p>GVJ gjithashtu konstatoi se institucioni përgatit raport të plotë vjetor çdo vit, tek i cili vlerësimi i cilësisë, është një nga çështjet e analizuara dhe vlerësuara. Ndonëse raportet më të fundit vjetore nuk ishin përfshirë në dosjen e vlerësimit, GVJ i aksesoi drejtëpërsëdrejti nga faqja web e Universitetit, siç vijon: https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-for-mas.</p> <p>Raporti vjetor 2020-2021, kapitulli 4 “Relacion në lidhje me plotësimin e standarteve shtetërore”, germa F, “Raportim i përgjithshëm tabular i të dhënave të vlerësimit të studentëve ndaj personelit akademik” paraqiten disa të dhëna, por tepër të përgjithshme, pa specifikuar as fakultetin, as programin, as lëndën dhe as pedagogun.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik</i> https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-for-mas.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të</p>	<p>Në Manualin e Cilësisë të Universitetit Epoka, përshkruhen parimet, procedurat dhe metodat për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë si dhe përcaktohen modelet e pyetësorëve dhe deklarimeve të tjera që përdoren në këtë proces.</p> <p>Në takimin me përfaqësues të NJBSC, Zyrës së Sigurimit të</p>

<p>studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Cilësisë dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në Universitet përdoren metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: analiza bazuar në tregues të matshëm cilësisë si nota mesatare në hyrje, kalueshmëria sipas lëndëve/moduleve, vlerësime të punës së pedagogëve përgjatë semestrit nga komisioni për kryerjen e kontrolleve në leksione, rishikime vjetre të syllabuseve, analiza e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor si dhe përfshirja e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, rezultat i angazhimit të stafit akademik në projektet “exchange mobility”.</p> <p>Gjithashtu përdoren edhe metodat e drejtëpërdrejta të përfshira në programet e lëndëve të tilla si:</p> <p>a) Vlerësimi me pikë për pjesëmarrjen në klasë të studentit;</p> <p>b) Vlerësimi me notë dhe pikë;</p> <p>c) Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët;</p> <p>d) Vlerësimi i përfshirjes së studentëve në aktivitete jashtëshkollore.</p> <p>Në shërbim të këtij procesi janë dokumentat:</p> <p>Udhëzues “Për Funkcionimin e Bordit të Provimeve”, shtojca 38, Udhëzues për Provimet, shtojca 37; Formularit të Vlerësimit të Provimit në shtojcën 62; Formular I Anketës së Instruktorit të Lëndës në shtojcën 29.</p> <p><i>Aneksi 29. Formular i anketës të pedagogut të lëndës.</i></p> <p><i>Aneksi 37 Udhëzues “Për provimet”</i></p> <p><i>Aneksi 38. Direktiva “Për Funkcionimin e Bordit të Provimeve”</i></p> <p><i>Aneksi 62. Formular i vlerësimit të provimit.</i></p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i></p> <p><i>https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-for-mas.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi se në institucion përdoren rregullisht edhe teknikat e tërthorta të vlerësimit si pyetësorët e studentëve për vlerësimin e procesit mësimor në fund çdo semestri. Zyra e Alumni dhe Karrierës e Universitetit në bashkëpunim me departamentin organizon Panairin e Karrierës, që shërben edhe për përfshirjen e bashkëpunëtorëve jashtë Universitetit në procesin e vlerësimit. Gjithashtu, në institucion funksionon dhe Bordi i ALUMNI, si një organ konsultativ që synon përfshirjen e ish-studentëve në aktivitetet dhe shkëmbimin e eksperiencës në Universitet.</p> <p>RVB informon se Anketa e Vlerësimit të Pedagogut të Lëndës, është një nga mënyrat jo të drejtëpërdrejta që përdoret për vlerësimin e cilësisë. Kjo anketë plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri, ku studentët japin mendimin e tyre për pedagogun dhe përmbajtjen e lëndës. Në fund të çdo semestri, bazuar në rezultatet e pyetësorit, departamenti përkatës përgatit një raport i cili përfshin të dhëna sasiore, cilësore, analiza dhe</p>

	<p>plan veprimi. Evidenca shtesë të dërguara nga GVB Shtojca plotësuese Nr 1-6.</p> <p><i>Aneksi 29. Formular i anketës të pedagogut të lëndës.</i> <i>Aneksi 62. Formular i vlerësimit të provimit.</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-for-mas. <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 2 Vendimi I Rektoratit mbi Raportin dhe rekomandimet e dhëna nga bordi i provimeve.pdf</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 3. raporti-vjetor-2020-2021</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 4 The Action Plan in Response to the Recommendations</i> <i>Shtojca Plotësuese Nr. 5 Evidenca mbi diskutimet në nivel departamenti mbi propozimet mbi kurrikulen</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 6 Alumni Survey Evaluation Report BUS</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se kadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në Statut si dhe në Manualin e Cilësisë paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në institucion, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat e tjera të institucionit.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, statutin dhe rregulloret e Universitetit Epoka, GVJ vlerëson se njësia bazë</p>

<p>bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimin me drejtuesin dhe stafin akademik të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se jo vetëm grupi i caktuar, por i gjithë stafi i angazhuar tek programi që vlerësohet, kontribuon në mënyrë të rregullt në procesin e vlerësimit të brendshëm me analiza, raporte dhe sugjerime.</p> <p>Në Kodin e Etikës së Universitetit jepen parimet e etikës akademike dhe publike të detyrueshme për të gjithë, në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, si edhe shprehet qartë angazhimi i Universitetit për respektimin e integritetit dhe shmangien e diskriminimit duke adresuar në mënyrë të kujdesshme të gjitha problemet etike të studentëve dhe personelit gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>Aneksi 2. Statuti i EPOKË-s</i> <i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vvera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit synohet edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit.</p> <p>Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të Universitetit Epoka dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në Universitetin Epoka, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ vlerëson se publikimet në faqen zyrtare web të institucionit respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën EIS.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ supozoi se analizat vjetore shoqërohen me diskutime në departament si edhe me rekomandime dhe plane masash për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësia bazë.</p> <p>Ndonëse GVJ nuk e përjashton mundësinë e diskutimit të problemeve më kritike të evidentuara si edhe diskutimin rreth praktikave më të mira, për më tepër që këto çështje janë trajtuar në Analizën vjetore 2020-2021, dhe GVB ka paraqitur dokumentacion plotësuese, përkatësisht Shtojcat 1 mbi dokumentimin e rezultateve për vlerësimin e cilësisë.</p> <p>GVJ inkurajon njësinë të hartojë një plan masash përpara fillimit të vitit akademik, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.</i> <i>Vizita në institucion.</i> <i>Shtojca plotësuese Nr. 1- Vendimi Rektorati mbi raportin e departamentit dhe planin e veprimit, Vendimi I Rektoratit mbi Rekomandimet</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse nuk konstatoi ndonjë sistem vlerësimi të posacëm për matjen e efektivitetit dhe ndikimit të këtyre veprimtarive për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, GVJ vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e stafit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në Universitet,</p>




me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

GVJ konstatoi se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri harmonizohen me mbledhjet e komisioneve, bordit të administrimit, publikime në faqen zyrtare web të Universitetit dhe platformën EIS, si dhe publikime në rrjetet sociale, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

*RVB_Bachelori_Marketing Ndërkombëtar Menaxhim Logjistik.
Vizita në institucion.*

Shkalla e përmbushjes së standardit				
		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI				
		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” të Institucionit të Arsimit të Lartë “EPOKA”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është risi në sistemin Arsimor Shqiptar, dhe konkretisht në edukimin marketing në Shqipëri duke orientuar marketingun drejt prirjeve ndërkombëtare në përputhje me integrimin në BE dhe globalizimin. Programi është pioner në thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve në funksionin e logjistikës ndërkombëtare, si kontribut në zhvillimin e aftësive menaxheriale të bizneseve eksportuese shqiptare.
2. Programi i studimit “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Departamenti i Administrim Biznesit i Universitetit EPOKA i cili ka një vizion, mision dhe plan zhvillimi strategjik efektiv dhe të qëndrueshëm. Programi i studimit është ndërtuar mbi këtë përvojë të mirë institucionale dhe reflekton vlerat akademike dhe shkencore të saj.
3. Programi i studimit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” përforcon profilizimin e studentëve në Marketing si një mundësi për lidhjen e studentëve me një funksion menaxherial marketing ose logjistikë që në ciklin e parë të studimit.
4. Ekzistenca e një rrjeti të gjerë partnerësh e bashkëpunëtorësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ekspertë të fushës së shkencave ekonomike si pjesë e vazhdueshme e aktiviteteve të Universitetit Epoka ndikon jo vetëm në konkretizimin e njohurive në auditor por edhe në rritjen e shanseve të punësimit.
5. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Departamenti i Administrim Biznesit i Universitetit EPOKA është pajisur me infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor në standardet e institucioneve analoge ndërkombëtare.
6. Sistemi i automatizimit të të dhënave dhe administrimi online i të dhënave nga njësitë kryesore rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve, si dhe transparencën ndaj tyre dhe stafit.
7. Aksesit në literaturë shkencore përmes fondit të librave në bibliotekë dhe bibliotekave online në bazat kryesore të të dhënave të kërkimit si JSTOR, EBSCO etj për pedagogë e studentë.

Pika të dobta:

1. Mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu dhe e evidencave e të dhënave të tregut që dëshmojnë për nevojën e tregut shqiptar për specialistë të fushës.



2. Përparësitë e këtij program, si i vetmi i këtij lloji në vendin tonë, nuk mbështeten në evidenca dhe nuk argumentohet qartë lidhja ndërmjet Menaxhimit Logjistik dhe Marketingut Ndërkombëtar në mënyrë që të dallojë qëllimin dhe objektivat e tij nga programe të tjera Bachelor në fushën e biznesit.
3. Numër i limituar i lëndëve karakterizuese në fushën e Logjistikës dhe të Marketingut Ndërkombëtar.
4. Pjesa më e madhe e personelit akademik të këtij programi studimi, si rrjedhojë e moshës së re, nuk ka eksperiencën dhe kualifikimit e mjaftueshëm për mësimdhënie në këtë program studimi.

Rekomandime:

1. Njësia përgjegjëse e programit Bachelor në “Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik” të ndërmarrë një studim të argumentuar dhe shkencor tregu në funksion të indentifikimit të nevojave të tregut të punës dhe aftësinë e programit për të përcjellë kompetencat e duhura tek studentët.
2. Njësia përgjegjëse të rishikojë prirjet dhe ndryshimet e shpejta në fushën e Marketingut me orientim në logjistikën ndërkombëtare në mënyrë që të përforcojë avantazhet e tij në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit.
3. Të rishikohet kurrikula, në harmoni me kërkesat e punëdhënësve për sektorin e marketingut dhe aplikimin e parimeve të menaxhimit logjistik ndërkombëtar në sektorin logjistik vendas në përafrim të praktikave rajonale, si dhe të rritet numri i lëndëve të formimit karakterizues të detyrueshme në raport me lëndët me zgjedhje.
4. Të rritet numri i PAE me grada dhe tituj si kusht për mësimdhënie në programin e studimit dhe zhvillimin e kompetencave kërkimore-shkencore të tij. Të mbulohen të gjitha lëndët e programit me titullarë sipas dispozitave ligjore në fuqi.




**Conclusions of the evaluation of the first cycle study program, Bachelor in
"International Marketing and Logistic Management" of the University "Epoka".**

Strengths and Affirmations

1. The study program is a novelty in the Albanian Education System, and specifically in marketing education in Albania, orienting marketing towards international trends in line with EU integration and globalization. The program is a pioneer in deepening the knowledge and skills of students in the function of international logistics, as a contribution to the development of managerial skills of Albanian businesses.
2. The study program "International Marketing and Logistics Management" is offered by the Faculty of Economic and Administrative Sciences, Department of Business Administration of EPOKA University which has an effective and sustainable vision, mission and strategic development plan. The study program is built on a rewarded institutional experience and reflects its academic and scientific values.
3. The Bachelor study program in "International Marketing and Logistics Management" reinforces the profiling of students in Marketing as an opportunity to connect students with a marketing or logistics management function in the first cycle of study.
4. The existence of a wide network of national and international partners and collaborators, experts in the field of economic sciences as a continuous part of the activities of Epoka University affects not only the concretization of knowledge in the auditorium but also the increase of employment opportunities.
5. The Faculty of Economic and Administrative Sciences, Department of Business Administration of EPOKA University is equipped with the necessary infrastructure to develop a teaching process as modern as possible in the standards of analogous international institutions.
6. Data automation system and online data administration increases the quality of services to students, as well as security and transparency to the staff.
7. Access to scientific literature through the fund of books in the library and online libraries in the main research databases such as JSTOR, EBSCO etc. for professors and students.

Weaknesses:

1. Lack of a proper market study and evidence of market data that testify to the need of the Albanian market for specialists in the field.
2. The advantages of this program, as the only one of its kind in our country, are not based on evidence and the connection between Logistics Management and




International Marketing is not clearly argued in order to distinguish its purpose and objectives from other bachelor programs in the field of business.

3. The program offers a limited number of compulsory profile courses in the field of International Logistics and Marketing.
4. Most of the academic staff of this study program, as a result of their young age, do not have sufficient experience and qualification for teaching in this study program.

Recommendations:

1. The responsible unit of the Bachelor program in "International Marketing and Logistics Management" need to undertake a reasoned and scientific market study in order to identify the needs of the labor market and the ability of the program to convey the appropriate competencies to students.
2. The responsible unit need to review the trends and rapid changes in the field of Marketing with orientation in international logistics in order to reinforce its advantages in relation to other Bachelor programs offered in the field of business.
3. To review the curriculum in line with the requirements of employers for the marketing sector and the application of the principles of international logistics management in the domestic logistics sector in the approximation of regional practices and to increase the number of compulsory profile courses in comparison to the elective courses.
4. To increase the number of academic staff with degrees and titles as a condition for teaching in the study program and the development of its research-scientific competencies. To cover all subjects of the program with academic staff according to the legal provisions.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE		X		
VLERËSIMI TËRËSOR		X		